REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS



UDHËZUES

I PËRGJITHSHËM I MASH

PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT
NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021
NË KUSHTET E PANDEMISË
COVID 19



FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

KOSOVA
që duam

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by:
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Mbështetur nga zyra e **UNICEF** në Kosovë

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SHKENCËS

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG
Büro Kosovo

KOSOVA
që duam

german cooperation
DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by:
giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Mbështetur nga zyra e **UNICEF** në Kosovë

UDHËZUES
I PËRGJITHSHËM I MASH

PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT
NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021
NË KUSHTET E PANDEMISË
COVID 19

Informata për dokumentin
Ky dokument u përpilua nga grupi punues i themeluar nga Ministri i MASH, Ramë Likaj me vendim nr 01-43 të datës 17/072020 dhe procesi i finalizimit të tij u përkrah nga GIZ, FES dhe UNICEF.

Grupi punues

Feime Llapashtica, kryetare
Luan Kryeziu, nënkryetar
Arber Salihu, anëtare
Habibe Buzuku, anëtare
Lulavere Behluli, anëtare
Nazan Safqi, anëtare
Fetah Kasumi, anëtar
Valbona Mjeku, anëtare
Veton Alihajdari, anëtar
Valbona Hadri, anëtare
Nebih Behluli, anëtare
Enver Mekolli, anëtar
Saranda Ceku, anëtare
Besim Avdimetaj, kryetar i kolegjiumit të drejtorëve anëtar
Majlinda Nushi, përfaqësuese e prindërve, anëtare
Dafina Miftari, drejtoreshë në shkollën "Pjetër Bogdani" anëtare
Nora Ajeti, mësimdhënëse, aneëtare
Rrezarta Zhinopotoku, GIZ, anëtare
Vjollca Shala. nënkryetare SBASHK, anëtare
Kozeta Imami, UNICEF, anëtare
Jusuf Thaqi, anëtar
Shqipe Bruqi, anëtare
Ryve Prekorogja, anëtare
Laberi Luzha, anëtare
Shpresa Shala, DKA - Prishtinë, anëtare
Muhamer Ibriqi, AAAPRR, anëtar
Fatmir Elezi, DVSM, anëtar
Faik Ispahiu, anëtar
Agim Berisha, mësimëdhënëse shkolla profesionale, anëtar

Në hartimin e dokumentit ndihmuan edhe:

Bardha Qirezi, EduTASK,
Besa Luzha, Platforma Kosova që duam -FES
Alberta Alihajdari, GIZ
Rrezarta Zhinipotoku, GIZ
Florije Kryeziu, UNICEF

Dokumenti u finalizuar nga MASH dhe u rikonfirmua nga ISHPK, më datën 10.08.2020.

Pas prezantimit dhe diskutimit publik të dokumentit në komisionin parlamentar për arsim dhe shkencë në Kuvendin e Kosovës më datë 12.08.2020 si dhe shqyrtimit të rekomandimeve, sugjerimeve e plotësimeve nga takimi me donatorët dhe organizatat përkrahëse të arsimit në Kosovë, më 12.08.2020, dokumenti u aprovua dhe të gjtiha institucionet relevante përfshirë DKA-të dhe shkollat obligohen ta zbatojnë në tërësi dhe me përpikmëri duke përfillur rrethanat dhe specifikat përkatëse lokale duke filluar nga data 17.08.2020.
Ky dokument dhe dokumentet tjera plotësuese do të shqyrtohen në vazhdimësi për t'iu përshtatur rrethanave epidemiologjike të pandemisë COVID-19 ne vendin tonë.

PËRMBAJTJA

Hyrje 9
Qëllimi 9
Parimet e udhëzuesit 9
Mirëqenia e fëmijëve/nxënësve 9
Qasja në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës 10
Zhvillimi i kompetencave 10

1. Korniza e Planifikimit 11
Politikat 11
Nivelet e rrezikshmërisë 12
Veprimtaria e Sigurtë 14
TASK FORCA në nivel të MASH-për arsimin parauniversitar 14
TASK Forca në nivel DKA 14
TASK Forca në nivel institucioni parashkollor/shkollë 15
Përgjegësitë e pjesëmarrësve 15
Të dhënat që mbledhen dhe raportohen 20
Qasja e grupeve të margjinalizuara dhe mirëqenja 21
Fëmijët/Nxënësit me vështirësi ekonomike-sociale 21
Fëmijët/Nxënësit nga minoritetet dhe refugjatët 21
Fëmijët/Nxënësit me nevojat e veçanta 21
Buxheti për masat Covid 19 22

2. MASAT HIGJIENIKE DHE MBROJTËSE - RREGULLAT E SJELLJES DHE PASOJAT PËR ORGANIZIMIN SHKOLLOR 25
Përgjegjësitë për higjienën dhe masat, lista e kontrollit dhe inspektimit 27
Përgatitja e nxënësve për shkollë 28
Udhëtimi për në institucionin arsimor 28
Rregullat në oborrin e shkollës 29
Rregullat brenda shkollës 30
Rregullat në klasë 33
Rregullat në sallen e mësimdhënësve 34
Rregullat për personelin e shkollës 34
Masat higjienike në ndërtesë 35

3. ORGANIZIMI I VITIT SHKOLLOR DHE I SHKOLLËS, PËRKRAHJA E NXËNËSVE sipas skenarëve A, B dhe C 39
Aplikimi i Skenarëve 39
Prioritet 41
Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (Edukimi parashkollor) 42
Të Përgjithshme 42
Zbatimi i Kornizës kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore
SKENARI A - KTHIMI I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE
Skenari C Mësimi në distancë I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE 43
Udhëzime për vlerësim 44
Arsimi Fillor dhe Arsimi i Mesëm i ulët Klasat 1-9 46
Të Përgjithshme 46
Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 1-9 46
Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore 46
SKENARI A - KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLË 46
Skenari II B Mësimi i kombinuar (prezencë dhe mësim në distancë) 51
Skenari C Mësimi në distancë 53

Arsimi i Mesëm i lartë – Gjimnazet Klasat 10-12 55
Të Përgjithshme 55
Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 10-12 55
Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore 55
SKENARI A - KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLË Gjimnazet Klasat 10-12 55
Skenari B Mësimi i kombinuar (prezencë dhe mësim në distancë) 57
Skenari C Mësimi në distancë 58
Arsimi i Mesëm i lartë – INSTITUCIONET E ARSIMIT DHE AFTËSIMIT PROFESIONAL, KLASAT 10 - 12 60
Të Përgjithshme 60
Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 10-12 60
Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore 60
SKENARI A - KTHIMI I NXËNËSVE NË Shkollat Profesionale dhe Qendrat e Kompetencës Klasat 10-12 61
Skenari B Mësimi i kombinuar (prezencë dhe mësim në distancë) 63
Skenari C Mësimi në distancë 65
4. Zbatimi i Kurikulës dhe Udhëzimet Metodologjike 67
Zbatimi i dokumenteve kurrikulare dhe Plan- programeve mësimore /lëndore dhe orarit në kushte pandemie me COVID-19 67
Kompetencat 67
Reduktimi i përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndëve (RNL) dhe (RNF) 68
REKOMANDIMET PËR ORGANIZIMIN METODIK-DIDAKTIK TË PROCESEVE TË MËSIMDHËNIES DHE MËSIMNXËNIES 69
Parime shtesë relevante për mësimin në kushtet emergjente 70
SKENARI A dhe B Mirëpritja e nxënësve përsëri në shkollë 71
SKENARI A, B dhe C - Krijimi i mënyrave të personalizuara/ individualizuara të të nxënit 71
Skenari C- Mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit - mësimi në distancë 72
Mësimi Plotësues 72
Udhëzimet për Vlerësim 74
Vlerësimi i nxënies duhet të jetë në përputhje me mësimdhënien e realizuar dhe e bazuar në matjen e arritshmërisë së rezultateve të parapara të të nxënit sipas kurrikulës (RNF) dhe (RNL) si dhe në nivele e shkallë (RNSH)
Funksionet e vlerësimit 74
5. DIGJITALIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLA-PLATFORMAT, PËRGATITJA DHE ZBATIMI I MËSIMIT ONLINE 76
Gjithpërfshirja 76
Lidhja me Internet 77
Posedimi i pajisjeve 77
Transformimi i përmbajtjes online dhe përdorimi i platformave 77
Elementet kyqe për përgjedhjen e zgjidhjeve teknologjike në edukim 80
6. Monitorimi dhe inspektimi 82
7. Trajnimi i mësimdhënësve, Personelit menaxherial dhe përkrahës të shkollave dhe akterëve tjerë 84
Trajnimet obliguese kualifikuese për mësimdhënës
Trajnimet e Propozuara 85



Organizimi i mësimit për vitin shkollor **2020/2021** në kushte të pandemisë **COVID19** në Republikën e Kosovës.

1. HYRJE

Qëllimi

Organizimi i mësimit për vitin shkollor 2020/2021 sipas skenarëve A dhe B dhe C, bëhet me qëllim që të ndihmohet ruajtja e shëndetit të fëmijëve/nxënëseve, mirëqenies shëndetësore të qytetarëve si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas Kornizës së Kurrikulës të Kosovës (KKK), kurrikulave bërthamë për tre nivelet te arsimit parauniversitar, dhe plan-programeve mësimore/lëndore për secilën klasë në kushte të pandemisë COVID - 19 në Republikën e Kosovës.

Mësimi sipas skenarëve mundëson organizimin e mësimit sipas kushteve epidemiologjike në vend duke përfshirë edhe kushtet e rihapjes së institucioneve edukativo arsimore me masa të shtuara për shëndetin publik, kushte të mbylljes së pjesshme apo kushte të mbylljes së plotë për shkak të rrezikshmërisë së shëndetit nga pandemia COVID 2019.

Në këtë udhëzues trajtohen çështjet në vijim:

- Korniza e Planifikimit (Politikat, veprimtaria e sigurtë, përgjegjësitë e pjesëmarrësve, grupet e margjinalizuara, dhe Financimi);
- Masat e përgjithshme për mbrojtjen nga COVID 19;
- Organizimi i edukimit/mësimit sipas skenarëve për të gjitha nivelet dhe udhëzimet metodologjike;
- Zbatimi i Kurrikulës dhe Udhëzimet Metodologjike;
- Digjitalizimi i edukimit/mësimit;
- Trajnimi i edukatoreve/ mësimdhënësve për mësimin në institucionet edukative arsimore dhe online;
- Monitorimi nga Inspektorati i arsimit i MASH.

Parimet e udhëzuesit

Jeta e fëmijëve/nxënësve gjatë pandemisë COVID-19 është krejtësisht e ndryshme nga ajo që ka qenë më parë, andaj me shumë se kurdoherë, përqëndrimi i institucioneve edukativo arsimore duhet të jetë tek shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve /nxënësve. Udhëzuesi udhëhiqet nga parimet themelore që lidhen me të drejtat e secilit fëmijë/nxënës që pa marrë parasysh gjendjen ekonomike, gjininë, përkatësinë etnike, gjuhën, aftësitë e kufizuara, të përfshihet në edukim/arsim dhe të përfitojë maksimalisht bazuar në nevojat individuale të tyre. Parimet bazë me të cilat udhëhiqet udhëzuesi janë:

Mirëqenia e fëmijëve/nxënësve (shëndeti mendor dhe përkrahje psikosociale)

Pandemia COVID-19 ka sjellë frikë, ankth dhe pasiguri tek të gjithë. Fëmijët janë ata që i vuajnë më shumë këto pasoja. Në këto kushte qëllimi kryesor i edukimit dhe arsimit duhet të jetë mirëqenia e fëmijëve/nxënësve. Puna e mësimdhënësve duhet të përqëndrohet në

mbështetjen e fëmijëve për të nxënë. Nëse edukatorët/mësimdhënësit janë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm ndaj fëmijëve/nxënësve, atëherë do të shmangen efektet negative psikologjike që mund të shkaktojë pandemia tek ata.

Qasja në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës - Situata në të cilën gjendemi ka thelluar edhe me shumë pabarazitë në mes të fëmijëve, andaj parësore është krijimi i mundësive të barabarta për t'i trajtuar dallimet e fëmijëve/nxënësve në procesin e mësimnxënies dhe nevojat e tyre të veçanta, duke kontribuar që çdo fëmije\nxënësi t'i ofrohet mundësia që të përfshihet , shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar, i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi edukativo arsimor. Gjatë realizimit të procesit edukativo-arsimor, edukatorët/mësuesit duhet të jenë gjithëpërfshirës, fleksibël dhe të përdorin forma të përshtatshme të punës për fëmijët/nxënësit me nevojat të veçanta, për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, për fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike, për fëmijët që kanë mungesë të qasjes në teknologjinë e nevojshme për të mësuar në distancë (p.sh., internet të shpejtë ose kompjuter në shtëpi).

Shkolla të sigurta për të gjithë fëmijët dhe adoleshentët - duke pasur parasysh përcjelljen e mundshëm të infeksionit me COVID-19 në mes të nxënësve dhe mësimdhënësve, shkollat duhe të sigurojnë nyje sanitare e ujë të rrjedhshëm sidhe pajisje dhe praktika të higjienës personale. Per sigurim të kësaj, nevojitet një bashkëpunim i ngushtë me prindërit dhe pjesëmarrje aktive të tyre në procesin e planifikimit në nivel shkolle. Shkollat e sigurta do të fuqizohen kur nxënësit dhe adoleshentët të kenë një rol aktiv në shpërndarjen dhe promovimin e mesazheve të masave dhe praktikave parandaluese ndaj Covid -19.[1]

Zhvillimi i kompetencave - gjatë modifikimit të orarit edukativo-arsimor në rrethana pandemie të merren për bazë kompetencat kyçe që duhet të arrije secili fëmijë/nxënës, e të cilat janë të përcaktuara në Standardet e Zhvillimit për Fëmijëri të Hershme dhe Kornizën e Kurrikulës të Kosovës. Kjo nënkupton që mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm në modifikimin, realizimin e përmbajtjeve lëndore përmes përdorimit të metodave dhe teknikave të ndryshme të mësimdhënies të cilat duhet të jene në përputhje me moshën e fëmijëve/nxënësve por edhe t'i përshtaten, përmbajtjes, kushteve, rrethanave në të cilën ndodhemi në mënyre që të arrihen rezultatet e përcaktuara me programet lëndore dhe Kornizën e Kurrikulës të Kosovës.

Autonomia dhe feksibiliteti - Me kornizën kurrikulare rregullohen qartë normat e autonomisë dhe të feksibilitetit në nivel shkolle. Kjo ka të bëjë me mundësinë dhe përgjegjësinë e personelit të shkollës për hartimin e planit vjetor të punës dhe shfrytëzimin feksibil të kohës mësimore duke mundësuar organizimin e orëve mësimore sipas kërkesave të përcaktuar me KKK për fusha kurrikulare, respektivisht lëndë mësimore si planifkimin e orëve të mësimit plotësues, shtues, planifkimin e aktiviteteve ekstrakurrikulare (jashtëkurrikulare), e formave të mësimdhënies interaktive, mjeteve mësimore dhe çështjeve të tjera në kontekstin e mësimdhënies dhe nxënies holistike dhe zhvillimit të kompetencave.

[1] https://unicef.sharepoint.com/teams/ECARO-Education/SitePages/Considerations-for-quality-and-inclusive-education.aspxConsiderations for education decision-makers at national, local and school levels, UNICEF Europe and Central Asia – Area 4 Safe schools

1.KORNIZA E PLANIFIKIMIT

Sipas kornizës për rihapjen e institucioneve edukativo arsimore të aprovuar nga UNESCO, UNICEF, Banka Botërore, ËFP, dhe UNHCR,[2] hapja e institucioneve edukativo arsimore duhet të ketë prioritet interesin e fëmijëve/nxënësve dhe shëndetin publik, duke u bazuar në përparësitë dhe rreziqet të cilat vijnë me hapjen e shkollave dhe duke u bazuar në faktorët e tjerë kontekstual dhe socio- ekonomik.

Sipas kësaj kornize, kur institucionet edukativo arsimore të hapen, disa nga faktorët që merren parasysh janë: 1) **politikat**, 2) **veprimtaria e sigurtë e shkollave** 3) **qasja e grupeve të margjinalizuara dhe mirëqenja**, dhe 4) **financimi.** Përzgjedhja e politikave, përgatija dhe financimi janë parakusht për realizimin e procesit edukativo arsimor sipas skenarëve të përshtatshëm për kontekstin e Kosovës.

Politikat

Planifikimi dhe zbatimi i skenareve bëhet në bazë të rekomandimeve të OBSH, IKSHPK, MSH dhe vendimeve të qeverisë për nivelin e rrezikut nga COVID 19 dhe masat në fuqi në kohën e zbatimit të këtyre skenareve. Tabela 1 propozon nivelet e rrezikshmërisë dhe aplikimin e skenarëvëve A, B dhe dhe C sipas situatës epidemiologjike.

Skenarët mund të ndryshojnë në rajone të caktuara, megjithatë ndërlidhshmëria e nivelit të rrezikut dhe skenarit duhet të jetë e qartë për të gjithë akterët. Pjesë e Politikave janë edhe udhëzuesit e caktuar dhe përgjegjësitë e akterëve. Të gjithë udhëzuesit e aprovuar nga MASH apo udhëzuesit që presin aprovim referohen në dokument në fusnotë, tek referencat apo edhe tek anekset.

Si veprim urgjent që kërkohet nga MASH është:

Të aprovohet struktura e nivelit të rrezikshmërisë dhe skenaret

Të revidohen dhe aprovohen udhëzuesit aktual

Të aprovohen udhëzuesit e përpiluar nga dikasterët të ndryshëm

Të aprovohet Plani i Veprimit

Të aprovohet Buxheti

2 Framework-for-reopening-schools-2020https://www.unicef.org/sites/default/files/2020-06/Framework-for-reopening-schools-2020.pdf



Nivelet e rrezikshmërisë



I LARTË



MESATAR



I ULËT

Tabela 1 Skenaret sipas niveleve të rrezikut/situatës pandemike

Niveli i rrezikshmërisë **Definimi/Kriteret/ Përshkrimi**	**Skenarët për Shkolla**	**Infrastruktura**	**Masat/ Përmbledhje** **(Masat e detajizuara higjienike, organizative dhe metodologjike gjenden në kapitujt e veçantë)**
SKENARI **A** Niveli i rrezikshmërisë i ulët  **(Hapje me masa)** Niveli i përhapjes Numri i ultë i infeksioneve Orari i lëvizjes Niveli i mbylljes	MËSIMI ME PREZENCË NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE DHE SHKOLLA-ME MASAT PARANDALUESE Rikthimi në institucionin parashkollor dhe shkollë me masa për siguri dhe shëndet, protokoll për COVID-19 dhe raportim të rregullt të mungesave të raportuara të ndëridhura me COVID-19 Prioritet institucionet parashkollore Në të njëjtën mënyrë shkolla duhet të veprojë edhe per arsimin e të rriturve	**Ventilimi** **Banjo** **Mjetet Dezinfektuese** **Poster informimi** **Mjete per kufizim/ distancë** **Interneti** **Uebfaqe** **Google Suite/Platforma**	**- Higjiena konsistente e duarve** **- Mbulimi i gojës me krah gjate kollitjes dhe teshtimes** **- Ajrosja e hapësirës/klasës pas çdo ore mësimi** **- Desinfektimi i hapësirës/klases pas çdo ndërrimi** **- Pastrimi i hapësirave sipas manualit dy herë në ditë** **- Mbajtja e maskave** **- Masat për mbajtjen e maskave dhe distancën sociale brenda dhe jashte grupit** **- Masa shtesë ose rishikim i aktiviteve me rrezik më të lartë (p.sh. këndimi, sportet)** **- Krijimi i grupeve me distancë mes tavolinave 1.5 metra** **- Caktimi i vendit për secilin fëmijë/nxënës dhe mos lejimi i ndërrimit të vendeve** **- Mbajtja e distancës gjatë pushimit** **- Ushqimi dhe transporti i sigurtë** **Organizim i përkrahjes për nxënësit që kanë vështirësi (mësim plotësues, ose orë shtesë)**

Tabela 1 Skenaret sipas niveleve të rrezikut/situatës pandemike

Niveli i rrezikshmërisë **Definimi/Kriteret/ Përshkrimi**	**Skenarët për Shkolla**	**Infrastruktura**	**Masat/ Përmbledhje** **(Masat e detajizuarahigjienike, organizative dhe metodologjike gjenden në kapitujt e veçantë)**
SKENARI **B** Niveli i rrezikshmërisë mesatar  **(Hapje e Pjesshme)** Niveli i përhapjes Numri i infeksioneve Orari i lëvizjes Niveli i mbylljes	RIKTHIM I PJESSHËM MËSIMI I KOMBINUAR-PREZENCË DHE MËSIM NË DISTANCË Prioritet Klasat 1-5 Numri maksimal në klasë 10 persona Orar i shkurtuar Mësim plotësues online Mësimi për të rritur, shkolla në mënyrë të njëjtë planifikon edhe mësimin e kombinuar –prezent dhe mësimin distancë për arsimin për të rritur	**Të gjitha më lartë dhe** **Ndarje fizike** **Klasa për IT Pajisja e nxënësve dhe mësimdhënësve me laptop/tablet**	**- Të gjitha me lartë dhe Mbajtja e grupeve me 10 persona** **- Orari i Rotacionit per stafin** **- Orari i takimeve fizike** **- Orari i mesimit online** **- Orari per krijimin dhe vendosjen e materialeve**
SKENARI **C** Niveli i rrezikshmërisë i lartë  **(Mbyllje)** Niveli i përhapjes Numri i infeksioneve Orari i lëvizjes Niveli i mbylljes	MËSIMI NË DISTANCË (TV +e-mësimi)		**- Stafi esencial, Masat sipas planit** **- Masat per huazimin dhe kthimin e mjeteve digjitale** **- Masat per dezinfektimin e pasjisjeve** **- Lista e kontrollit per nxënës dhe prindër** **- Orari i takimit fiks me orë të caktuara javore me mësimdhënës** **- Orari për takimet me psikolog apo për aktivitete tjera psiko-sociale** **- Listë kontakti me nxënës, aktiv dhe këshill**

Veprimtaria e Sigurtë

Për të siguruar që institucionet edukativo arsimore në nivel vendi dhe komune janë duke vepruar në mënyrë të sigurtë, sugjerohet të organizohen TASK forca në tre nivele: MASH, DKA dhe institucion parashkollor/shkollë.

TASK Forca në nivel të MASH-për arsimin parauniversitar

Të themelohet Task Forca në nivel të MASH dhe anëtarët e TASK forcës- të caktohen dhe tu specifikohen obligimet dhe përgjegjësitë bashkë me afatet:

1. **MASH-Kabineti i Ministrit**
2. **Udhëheqësit e divizioneve përkatëse ne MASH**
3. **Kryesuesi i Kolegjiumit të DKA-ve,**
4. **Përfaqësuesi nga IKSHP,**
5. **Përfaqësuesi i Mësimdhënësve**
6. **Përfaqësuesi i edukatorëve**
7. **Përfaqësuesi i Këshillit të Prindërve dhe të Nxënësve,**
8. **Zyra për komunikim e MASH**

- Të përpilohet një plan i punës i Task Forcës (ku përfshihen mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimarrjes);
- Verifikimi i skenareve me nivelin e rrezikshmërisë me MSH dhe IKPSHP;
- Monitorimi i zbatimit të skenareve në vitin e ri shkollor;
- Përcaktimi i masave përkrahëse për DKA-të.

TASK Forca në nivel DKA

Të themelohet Task Forca në nivel të DKA dhe anëtarët e TASK forcës- të caktohen dhe t'u specifikohen obligimet dhe përgjegjësitë bashkë me afatet:

1. **Kryetari i Komunës**
2. **Drejtori i DKA**
3. **Drejtori i Financave**
4. **Drejtori i Mirëqenies Sociale**
5. **Drejtori i Shëndetësisë**
6. **Inspektori Sanitar**

- Të përpilohet një plan i punës i Task Forcës (ku përfshihen mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimarrjes);
- Verifikimi i skenareve me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e shkollës;
- Monitorimi i zbatimit të skenareve në vitin e ri shkollor;
- Përcaktimi i masave përkrahëse për shkollat,

TASK Forca në nivel institucioni parashkollor/shkollë

- Të themelohet Task Forca në nivel të institucionit parashkollor/shkollës dhe anëtarët e TASK forcës- të caktohen dhe t'u specifikohen obligimet dhe përgjegjësitë bashkë me afatet:

    1. **Kryetari i Këshillit Drejtues**
    2. **Drejtori i Shkollës/Institucionit parashkollor**
    3. **Kryetari i Këshillit të Mësimdhënësve**
    4. **Kryetari i Këshillit të Prindërve**
    5. **Kryetari i Këshillit të nxënësve**
    6. **Kordinatori për Teknologji**
    7. **Përfqësuesi për Logjisitikë**

- Të përpilohet një plan i punës i Task Forcës (ku përfshihen mbledhjet e rregullta, orari, formati i takimeve, mënyra e vendimarrjes);
- Verifikimi i skenareve me nivelin e rrezikshmërisë në komunë dhe kushtet e shkollës;
- Monitorimi i zbatimit të skenareve në vitin e ri shkollor;
- Përcaktimi i masave përkrahëse për edukatorët/mësimdhënësit, fëmijët/nxënësit, prindërit dhe stafin tjetër të shkollës.
- Raportimi i mungesave të nxënësve dhe punonjësve tek Task Forca e DKA-së perkatese në baza ditore dhe të bëhet vlerësimi i mungesave dhe arsyes së mungesave duke i kontaktuar menjëherë, ata të cilët mungojnë.(sipas IKSHP)

Përgjegjësitë e pjesëmarrësve në procesin edukativo-arsimor

Përgjegjësitë për pjesëmarrësit në procesin edukativo arsimor dhe planfikimi dhe monitorimi bazuar në të dhëna është i mundshëm nëse detyrat dhe përgjegjësitë përcaktohen në mënyrë të qartë sidhe nëse mbledhen të dhënat e caktuara gjatë planfikimit dhe monitorimit. Në vijim detyrat dhe përgjegjësitë e pjesëmarrësve janë bazuar në tre udhëzues të aprovuar nga MASH,[3]. Ndryshimet janë paraqitur me nënvizim.

MASH

- **Aprovon Skenarët sipas nivelit të rrezikshmërisë;**
- **Komunikon në mënyrë të rregullt për aplikimin e skenarëve me DKA-të**
- **Themelon TASK Forcën;**
- **Aprovon Udhëzuesit;**

[3] DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË PËR REALIZIMIN E MËSIMIT NË DISTANCË-I REVIDUAR
https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/detyrat-dhe-pergjegjesite-per-realizimin-e-mesimit-ne-distance-mashti_1.pdf

- Përpilon Planprogramet për secilin nivel;
- Sugjeron specifikat për platformat digjitale;
- Aprovon tekstet shkollore;
- Pajisë shkollat me tekste shkollore fizike dhe digjitale;
- Koordinon me donatorë;
- Koordinon me DKA për plotësimin e kushteve për organizimin e procesit edukativo arsimor;
- Krijon një platformë për komunikim virtual (Kolegjiumi Virtual Arsimor) me të gjithë drejtorët e DKA-ve në Kosovë me qëllim të sigurimit të komunikimit efikas për përcjelljen e gjendjes lidhur me zhvillimin e mësimit online në territorin e komunave të tyre;
- Inspekton zbatimin eprocesit edukativo arsimor sipas skenarëve;
- PërkrahDKA dhe institucionet parashkollore dhe shkollat për aplikimin e skenarëve;
- Angazhon ekspertizë për çështje të veçanta apo hulumtime profesionale
- Aprovon Kalendarin e vitit shkollor 2020/2021 (7 shtator –fillimi, Periudha e Parë (Shtator 2020-Janar 2021), Periudha e dytë (Janar - Prill 2021), Periudha e tretë (Prill - Maj/Qershor 2021);
- Ofron sugjerime dhe përkrahje për mësimdhënien, vlerësimin dhe përkrahjen e fëmijëve/nxënësve për të arritur rezultatet e të nxënit dhe zhvillimin e kompetencave të Kurrikulës, sipas një plani të rishikuar(grupi i Kurrikulës dhe grupeve punuese për nivele të arsimit).

Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA)

- Themelojnë TASK Forcat ne nivel DKA;
- Koordinojnë dhe menaxhon institucioneve dhe të personelit arsimor në nivel të komunave me përqëndrim në realizimin e mësimit sipas skenarëve;
- Vendosin format e vendimmarrjes, raportimit dhe vlerësimit të performancës së personelit përmes komunikimit të kufizuar fizik dhe komunikimit nëpërmjet formave të aprovuara virtuale;
- Caktojnë platformën digjitale që do të përdoret në nivel komune/shkolle, ku në nivel shkolle përdoret vetëm një platformë unike;
- Organizojnë trajnimet për mësimdhënësit në nivel të komunës në bashkëpunim me MASH dhe Donatorë;
- Realizojnë kolegjiumin virtual (sipas paltformës së aprovuar) me të gjithë drejtorët e institucioneve parashkollore dhe shkollave për informim të rregullt, raportim dhe vlerësim të mësimit në distancë;
- Organizojnë takime individuale me drejtorë të linstitucioneve parashkollore /shkollave – gjithnjë duke pasur parasysh aspektet e sigurisë shëndetësore dhe mirëqenies së personelit;
- Raportojnë në baza ditore në MASH për ecurinë dhe sfidat e organizimit të mësimit në distancë;
- Komunikojnë në mënyrë efikase dhe të sigurtë me Këshillin e Prindërve në nivel komunal;

- Planifikojnë sigurimin dhe shpërndarjën e teksteve shkollore me kohë te nxënësit;
- Përpilojnë evidencën e shkollave dhe mësimdhënësve që nuk kanë pajisje (deri më 20 gusht);
- Sigurojnë pajisje të nevojshme (me ndihmën e MASH ose të donatorëve);
- Përkrahin edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë mbështetje për mësimin online (20 gusht-01 shtator);
- Furnizojnë me pajisje për procesin edukativo arsimor në distancë (sipas fushave mësimore dhe aktiveve të klasave nëpër institucione parashkollore/shkolla (1 aktiv i klasës ose 1 fushë mësimore =1 set i pajisjeve) dhe menaxhojnë shfrytëzimin e tyre të përbashkët;
- Japin udhëzimet të sakta për përgatitjen dhe ofrimin e mësimit sipas skenarëve, duke shfrytëzuar rrjetin dhe pajisjet në institucione parashkolore/shkollë, sipas orarit të përcaktuar;
- Përcaktojnë format e raportimit të mësimit në përputhje me udhëzimet e MASH sidhe caktojnë përkrahjen dhe informimin e nxënësve dhe prindërve;
- Sigurojnë internetin e qëndrueshëm për nxënësit dhe mësimdhënësit;
- Sigurojnë një zyrtar të teknologjisë informative ose mësimdhënës të dalluar të TIK, si pikë kontakti për shkolla lidhur me çështjet e digjitalizimit dhe mësimit nga distanca;
- Drejtoritë komunale të arsimit të bëjnë evidentimin e fëmijëve/nxënësve dhe edukatorëve/mësimdhënësve që kanë nevojë për pajisje si laptop dhe tablet.

Institucionet Parashkollore dhe Shkollat

- Janë përgjegjësit kryesor për realizimin e procesit edukativo arsimor;
- Kryejnë detyrat me rregull nga shkolla sipas skenarëve;
- Përgatisin klasat për punë të mësimdhënësve (shpërndarjen e kompjuterëve nga kabinetet në klasa);
- Ofron shërbimin përkrahës të IT-së përmes kordinatorit për digjitializim;
- Ofron përkrahejn për metodologjinë e mësimdhënies përmes koordinatorit të cilësisë dhe trajnimeve të përiluara specifikisht për këtë periudhë.

KDSH

- Takohen sipas funksionit të përcaktuar në Ligjin për Arsimin e Lartë;
- Themelojnë TASK Forcën në nivel shkolle;
- Shqyrtojnë raportet mujore.

Drejtoria

- Përgatisin Institucionin parashkollor/shkollën sipas skenarëve;
- Koordinojnë organizimin e mësimit sipas skenarëve dhe i raportojnë rregullisht DKA-së;
- Evidentojnë fëmijët/nxënësit që nuk kanë pajisje deri më 20 gusht;
- Evidentojnë edukatorët/mësimdhënësit që kanë nevojë për përkrahje shtesë për mësimin në distancë;
- Informojnë mësimdhënësit/aktivet e lëndëve dhe të klasëve me udhëzuesit, përmbajtjet e përcaktuara si të obligueshme (nga MASHT dhe DKA);
- Përcaktojnë oraret sipas skenarëve dhe kërkesave për MASAT Covid - 19
- Përcaktojnë orarin javor për mësimdhënësit për takimet virtuale me nxënësit;.
- Cakton një koordinatorpër teknologji dhe platforma;
- Krijon grup virtual arsimor me Këshillin e Shkollës dhe me kryetarët e aktivave profesionale në shkollë për të lehtësuar mbarëvajtjen e mësimit online në shkollë. Në rastet kur drejtori i shkollës nuk arrin realizimin e grupit virtual – atëherë ai / ajo angazhon një mësimdhënës për këtë qëllim.

Kryetarët e aktiveve lëndore

- Komunikojnë me anëtarët e aktivit me qëllim të përcjelljes së detyrave nga
- Drejtori dhe Këshilli i shkollës dhe për përkrahje të mësimdhënësve individualë;
- Këshillojnë mësimdhënësit, u ndihmojnë për tejkalimin e problemeve dhe përcjellin realizimin e kurrikulës bërthamë dhe realizimin e njësive mësimore;
- Komunikojnë aktivisht me kujdestarët e klasave dhe me mësimdhënësit për realizimin e mësimit (përmes komunikimit virtual te parovuar).

Mësuesit klasorë (1-5)

- Vazhdojnë angazhimin në kryerjen e detyrave të veta profesionale për realizimin e mësimit sipas skenarëve;
- Për klasat 1, 2 e 3, mësuesit krijojnë grupe virtuale (në Facebook ose Viber) me prindërit e fëmijëve të paralelës së vet;
- Në rast të mungesës së prindërve të një fëmije, mësuesit përfshijnë në rrjet një të afërm ose kujdestar të fëmijës. Përmes këtij rrjeti, mësuesit – mësueset informojnë, komunikojnë, përcjellin, këshillojnë, dhe mbikëqyrin zhvillimin e mësimit online dhe angazhimin e fëmijëve;
- Në veçanti mësuesit/mësueset do të kujdesen për kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe pjesëmarrjes në mësim;
- Mësuesit/mësueset përcjellin orarin e mësimeve online dhe komunikojnë me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve.

Kujdestarët e klasave (për Klasat 6-9 Dhe 10-12):

- Kryejnë detyrate veta profesionale për realizimin e mësimit online;
- Organizojnë grupe virtuale me nxënësit e paraleles së vet;
  Komunikojnë me mësimdhënësit e angazhuar në punë me klasën që kujdestarojnë;
- Përcjellin orarin e mësimeve online dhe komunikojnë me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve;
- Mbajnë mbledhje të prindërve sipas kushteve fizike ose virtuale.

Mësimdhënësit (1-12):

- Mësimdhënësit e çdo lënde të përcaktojnë një ditë të konsultimeve me klasët e veta;
- Organizojnë përkrahjen e ndonjë grupi të nxënësve me prezencë të herëpashershme në shkollë, sipas nevojës;
- Kryejnë detyrimeve të veta profesionale duke u përqëndruar në lehtësimin e realizimit të mësimit online;
- Krijojnë grupet virtuale me prindërit dhe nxënësit e vet;
- Detyra e mësimdhënësve është përcjellja e mësimit online, përkujdesja për aktivizimin e rregullt të nxënësve, përkujdesjen dhe përcjelljen e kryerjes së detyrave të shtëpisë, këshillimin e nxënësve për tejkalimin e sfidave, shpjegimin e pjesëve më të vështira, mbajtjen e evidencave e të tjera;
- Mësimdhënësit përcjellin orarin e mësimeve online dhe komunikojnë me prindërit për angazhimin e rregullt të nxënësve;
- Mësimdhënësit obligohen që çdo javë të raportojnë te drejtori i shkollës lidhur me mësimin.

Prindërit

- Të krijojnë kushtet dhe mjedisin e që fëmijët e tyre të marrin pjesë rregullisht në mësimin përfshirë edhe atë në distancë;
- Të përkrahin fëmijët, jo duke kryer detyrat në vend të fëmijës, por duke i mbështetur, këshilluar, sqaruar dhe ndihmuar që fëmija të ketë të qarte dhe të arrijë të përfundojë detyrat vete;
- Bashkëpunojnë me mësimdhënësit për të siguruar mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve të tyre, t'i inkurajojnë ata të mësojnë, të hulumtojnë dhe të organizojnë kohën e tyre sa më mirë gjatë mësimit në këto kushte shtëpie;
- Të përcjellin punën e fëmijëve dhe në bashkëpunim me mësimdhënësit, t'i ndihmojë ata për të gjetur mënyrën më të mirë për të mësuar në këto kushte;
- Të jenë pjesë e grupeve të komunikimit me mësimdhënësit për të marrë sa më shumë informacion lidhur me procedurat e mësimit në distancë, sipas

kushteve;

- **Të jenë pjesë e vendimeve për mënyrën e organizimit të mësimit në distancë, sidhe për vlerësimin e fëmijëve të tyre;**
- **Të mbështesin fëmijën në mësimin në kushtet e shtëpisë duke lehtësuar marrjen e informacionit nga mësimdhënësit.**

Të dhënat që mbledhen dhe raportohen

Të dhënat për numrin e nxënësve

- Numri i paraleve dhe nxënësve për paralele për klasat 1-5 për m2, (të regjistruar, vijojnë, nuk vijojnë, me aftësi të veçanta, me asistencë sociale, të infektuar);
- Numri i paraleleve dhe nxënësve për klasat 6-9 për m2 (të regjistruar, vijojnë, nuk vijojnë, me aftësi të veçanta, me asistencë sociale, të infektuar);
- Numri i paraleleve dhe nxënësve për paralele për klasat 10-12 gjimnaze për m2 (të regjistruar, vijojnë, nuk vijojnë, me aftësi të veçanta, me asistencë sociale, të infektuar);
- Numri i paraleleve dhe nxënësve për paralele për klasat 10-12 në shkolla profesionale për m2 (të regjistruar, vijojnë, nuk vijojnë, me aftësi të veçanta, me asistencë sociale, të infektuar).

Raportet

Të bëhet forma e raporteve standarde për përcjelljen e procesit edukativo arsimor në kohë pandemie për MASH dhe DKA, për këto raporte:

- Raporti Javor
- Raporti Mujor
- Raporti Tremestral

Infrastruktura e shkollave

- Gatishmëria Infrastrukturore;
- Gatishmëria për masat e higjienës (Plani/listat e kontrollit)
- Posedimi i pajisjes nga ana e nxënësit, llojit të pajisjes dhe me sa fëmijë ajo ndahet;
- Posedimi i pajisjes nga ana e mësimdhënësit, llojit të pajsisjes dhe me sa familjarë ajo ndahet;
- Përgatitja e klasës/klasave për digjitalizim të procesit edukativo-arsimor në secilën shkollë. Klasa shërben edhe për përdorimin e pajisjeve nga ana e mësimdhënësve;
- Përcaktimi i Platformës unike në shkollë dhe platformat shtesë (Standardizimi).

Qasja e grupeve të margjinalizuara dhe mirëqenja

Institucionet arsimore duhet t'u kushtojnë kujdes të veçantë fëmijëve që vijnë nga grupet e margjinalizuara, ata me gjendje të vështirë ekonomike-sociale, atyre me nevoja të veçanta, rome,ashkali dhe egjiptian etj, për të cilet kërkohet qasje individuale në mënyrë që ata të kenë qasje në arsim dhe të jenë pjesëmarres aktive në mësimnxënie.

Për qëllim të adresimit të grupeve të ndryshme të margjinalizuara sugjerohet që secila shkollë/klasë të identifikojë fëmijët/nxënësit në këtë kategori duke përfshirë: nxënësit me vështirësi ekonomike-sociale, nxënësit me nevoja të veçanta, nxënësit nga komunitetet dhe refugjatët. Përderisa vlejnë të gjitha ligjet dhe udhëzimet, një kujdes i shtuar kërkohet me qëllim të gjithëpërfshirjes dhe përkrahjes.

Sugjerohen masat në vijim, sipas grupeve të vecanta:

Fëmijët/Nxënësit me vështirësi ekonomike-sociale

Nxënësit me vështirësi ekonomike sociale ballafaqohen me vështirësi edhe më të madhe në kohë pandemie. Ata rrezikohen më së shumti për të braktisur shkollën dhe mësimin nga pamundësia e kushteve dhe përkrahjes në shtëpi.[5] Prandaj, nevojitet që të bëhet:

- Identifikimi i nevojave;
- Sigurimi i pakove emergjente ushqimore dhe higjienike;
- Prioritizimi në huazimin e pajisjeve;
- Referimi për përkrahje;
- Regjistrimi në klasë plotësues.

Fëmijët/Nxënësit nga minoritetet dhe refugjatët

Nxënësit e minoriteteve dhe refugjatë ballafqohen me vështirësi shtesë sidomos në vonesën e materialeve në gjuhën e tyre, apo edhe ballafaqimin me vështirësitë ekonomike/sociale qe u përmendën më lartë.

- Identifikimi i nevojave
- Sigurimi i materialeve dhe udhëzuesve në gjuhën e komunitetit
- Përkrahja për mësim të gjuhës nëse nuk flasin gjuhët zyrtare apo të komunitetve
- Sigurimi i pakove emergjente ushqimore dhe higjienike
- Prioritizimi në huazimin e pajisjeve

[4] SMIA https://masht.rks-gov.net/article/smia
[5] UNICEF (2020) LearnIn, Mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë Manuali i Mësuesit i platformës "LearnIn" për të nxënit gjatë emergjencave

Fëmijët/Nxënësit nga minoritetet dhe refugjatët

- Identifikimi i nevojave;
- Hartimi i Planit Inidividual të Arsimit (PIA) dhe zbatimi i tij nga mësimdhënësit);
- Bashkëpunimi dhe koordinimi me asistentet në shkolla ku janë të pranishëm;
- Regjistrimi në Platforma e rregullta të shkollës dhe përdorimi i platformës arsimi gjithëpërfshirës.net për tu pajisur me materiale didaktike;
- Bashkëpunimi me qendrat burimore për të marr shërbime dhe materiale didaktike për specifikat e nxënësve me nevoja të veçantaUdhëzuesi i veçantë për nxënësit me nevoja të veçanta mund ta gjeni në aneksin[6]?

Buxheti për masat Covid 19

Përveç politikave, planifikimi duhet të parashohë buxhetin e ndarë në nivel të ministrive, komunave dhe vijave buxhetore përkrahëse. Parimi kryesor në buxhetim duhet të ketë sigurinë dhe shëndetin publik, qasjen në mësimin sipas skenarëve dhe krijimin e kushteve për mësim nga distanca.

[6] Përfshirja dhe përkrahja e nxënësve me nevoja të veçanta gjate mësimit në distancë dhe Online

2.

MASAT HIGJIENIKE DHE MBROJTËSE -
Rregullat e sjelljes dhe pasojat për organizimin shkollor





2. MASAT HIGJIENIKE DHE MBROJTËSE

RREGULLAT E SJELLJES DHE PASOJAT PËR ORGANIZIMIN SHKOLLOR

Duke patur parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19 dhe me qëllim të parandalimit të përhapjes se virusit, bazuar në rekomandimet e IKSHPK[7] dhe dokumentit të OBSH me referencë për shkollat[8], MASH ka hartuar udhëzuesin për masat që duhet të ndërmirren në institucionet edukativo-arsimore për mirëqenien, mbrojtjen dhe sigurinë e nxënësve dhe stafit edukativo-arsimor.[9]



Masat e përcaktuara në udhëzues duhet të kuptueshme dhe me to duhet të pajtohen nxënësit, personeli dhe prindërit. Në rastin e fëmijëve të vegjël ose fëmijëve deri në moshën gjashtë vjeç (në çerdhe dhe kopshte) MASH ka përgatitur një udhëzues të veçantë: “Protokolli për masat lehtësuese për rifillimin e punës në institucionet parashkollore në Kosovë.”[10]

Masat dhe rregullat e bazuara në këta udhëzues duhet të ndiqen në mënyre që të sigurohet mirëqenia e nxënësve nga shtëpia deri në shkolle e që përfshin rregullat gjatë transportit për në shkolle, masat dhe rregullat në oborrin e shkollës, brenda hapësirave të shkollës për nxënësit, personelin dhe prindërit.Udhëzuesi poashtu ofron rregulla dhe informacione rreth mënyrës se organizmit dhe lëvizjes së nxënësve, personelit dhe prindërve brenda hapësirave shkollore dhe gjatë orarit të mësimit.

Rregullat në vijim duhët të respektohen në mënyrë strikte dhe te monitorohet zbatimi i tyre në vazhdimësi nga DKA-të dhe menaxhmenti i shkollave, perndryshe çdo mos zbatim dhe mos respektim i masave konsiderohet vepër penale, për shkak të dëmtimit të shëndetit të nxënësve dhe punonjësve.[11]

---

[7] MASH (2020) Udhëzues për shkolla: Udhëzime për mbrojtjen nga infeksioni COVID-19, në institucionet arsimit para universitar në Republikën e Kosovës

[8] NSTITUTI KOMBËTAR I SHËNDETËSISË PUBLIKE TË KOSOVËS (2020) MANUAL PËR MBROJTJE NGA PËRHAPJA E VIRUSIT COVID-19 https://msh.rks-gov.net/manuali-per-mbrojtje-nga-perhapja-e-virusit-covid-19/

[9] CDC https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/community/schools-childcare/schools.html

[10] MASH (2020)

[11] WHO (2020) Annex to Considerations in adjusting public health and social measures in the context of COVID-19

Vërejtje!

DKA-të dhe shkollat individualisht janë përgjegjëse për zbatimin strikt të MASAVE HIGJIENIKE ANTICOVID-19 NË SHKOLLA, sipas udhëzuesit të MASH dhe manualit të IKSHP, për të siguruar shëndetin dhe mirëqenien e nxënësve, mësimdhënësve dhe të gjithë personelit arsimor në shkollë, por edhe të gjithë komunitetit në përgjithësi.

Sipas CDC, "Sa më i madh të jetë kontakti i nxënësve dhe stafit mësimdhënës e teknik/administrativ me njerëz të tjerë, dhe sa më shumë që zgjat ky kontakt në distancë të afërt, aq më e madhe është mundësia e shpërndarjes së virusit COVID 19. Çdonjëri që ka kontakt në më pak se dy metra në më shumë se 10 minuta, konsiderohet si kontakt direkt (potencial i infektuar), nëse njëri nga individët rezulton pozitiv me virusin Covid -19 gjatë 48 orët e ardhshme (edhe nëse të dy individët kanë pasur maskë gjatë kontaktit).”

Udhëzimet dhe rekomandimet e dhëna për DKA-të dhe shkollat/institucionet edukativo-arsimore janë bazuar në dokumentet e institucioneve relevante ndërkombëtare dhe vendimeve të MASH e të institucioneve relevante të Republikës së Kosovës dhe duhet të ndiqen në mënyrë strikte nga çdo mësimdhënës, drejtor dhe staf ndihmës në shkollë, që të sigurohet mirëqenia e nxënësve **nga shtëpia deri në shkollë** (e që përfshin edhe rregullat gjatë transportit për në shkollë), masat dhe rregullat **në oborrin e shkollës**, e sidomos **brenda hapësirave të shkollës** për nxënësit, personelin dhe prindërit. Udhëzuesit e përgatitur nga MASH dhe IKSHP, ofrojnë detaje të bollshme për rregullat dhe informacionet rreth mënyrës së organizmit dhe lëvizjes së nxënësve, personelit dhe prindërve brenda hapësirave shkollore dhe gjatë orarit të mësimit. Ky dokument është një zbërthim më i shkurtër dhe praktik i hapave që duhet të ndërmirren nga DKA dhe shkollat për zbatimin e masave të rekomanduara.

Përgjegjësitë për higjienën dhe masat, lista e kontrollit dhe inspektimit

MASH - vendos standarde, lehtë të inspektueshme, udhëzime, rregulla dhe procedura të kontrollit/monitorimit, në këtë situatë të veçantë, në përputhje me këshillat e autoriteteve relevante (IKSHPK).

DKA - siguron procedurat e nevojshme për furnizimin me mjete për pastrim, dezinfektim etj. të bollshme dhe të nevojshme në bazë të standardeve të vendosura. Inspektorët sanitar dhe ata të punës inspektojnë në mënyrë të vazhdueshme procesin e zbatimit të standardeve të vendosura (p.sh numrin e punëtorëve teknik për m2 dhe për numër të nxënësve).

SHKOLLA - zbaton në përpikmëri udhëzimet, standardet dhe monitoron personelin teknik, sipas standardeve të vendosura (listat e kontrollit ditore, javore, mujore etj). Kujdeset që furnizimi me pajisjet e nevojshme të jetë në kohë dhe në sasi të duhur.

PRINDËRIT - marrin pjesë në planifikimin e masave, udhëzojnë fëmijët që të respektojnë rregullat dhe standardet e higjienës në shkollë/klasë, dhe marrin pjesë në aktivitete vetëdijësuese në këtë aspekt.

NXËNËSIT - zbatojnë rregullat e higjienës dhe promovojnë sjelljet e kujdesit të vazhdueshëm për higjienën e tyre personale dhe të ambienteve shkollore. (Mund të stimulohet kjo sjellje me disa procese rutinë: Klasa më e pastër (javës, muajit); nxënësi kampion në ruajtjen e higjienës; aktivitetet tematike (higjiena e trupit, higjiena e gojës, etj) si pjesë e edukimit shëndetësor dhe arritjes së kompetencave individ i shëndoshë dhe qytetar i përgjegjshëm.

PERSONELI TEKNIK NË SHKOLLË - zbaton standardet e higjienës në shkollë në aspektin;

- Kohor (ditë/javë - orë/ditë)
- Frekuenca e pastrimit (ditë, javë, muaj, kohë e pushimeve) -me orar të caktuar dhe lehtë të monitorueshëm
- Cilësia e pastrimit
- Kujdesi për përdorimin e materialeve jo të dëmshme
- Evidentimi i furnizimit dhe shpenzimit të materialit higjienik
- Kujdesi për furnizimin e vazhdueshëm të ambienteve të posaçme (banjot) me letër, sapun dhe (klasat) me dezinfektues
- Inventarizimi dhe evidenca e materialit higjienik
- Plotësimi i listave të kontrollit (ditore, javore, mujore) për të siguruar inspektimin e saktë

PROMOVIMI I SJELLJEVE QË REDUKTOJN SHKALLËN E SHPËRNDARJES SË VIRUSIT

MASH ka përcaktuar rregullat dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve për të inkurajuar sjelljet që reduktojnë shkallën e përhapjes së virusit në mesin e nxënësve dhe të personelit në shkollë.

LEXONI ATO ME KUJDES DHE BËNI PLANIN E VEPRIMIT (OPERACIONAL) TË SHKOLLËS TUAJ PËR ZBATIMIN E TYRE.

Përgatitja e nxënësve për shkollë

- Çdo nxënës duhet ta ketë maskën personale, e cila përdoret gjatë gjithë kohës së qëndrimit në ambiente të shkollës.
- Përpos maskave të siguruara nga DKA-të, partnerët, donatorët dhe vetë shkollat, MASh dhe Qeveria e Kosovës ka ndarë dhe ka planifikuar një pjesë të buxhetit për maska, mjete tjera mbrojtëse dhe dezinfektuese. Kështu që, shkollat do të kenë fond rezervë të maskave.
- Prindërit duhet t'i këshillojnë fëmijët për rregullat për mbrojtje nga Covid -19, posaçërisht për vendosjen e maskës dhe higjienën e duarve
- **Personat me simptoma! Qëndroni në shtëpi!** Kushdo që ka simptoma të Covid-19 nxënës, mësimdhënës, staf ndihmës, apo edhe nëse ndonjë anëtar i tyre i familjes është me COVID-19, **nuk duhet të vijë në institucionin edukativo-arsimor,** por duhet të lajmërohet drejtori i shkollës dhe mësuesi apo kujdestari i klasës. Drejtoria e shkollës menjëherë duhet të mbledhë informatat dhe në baza ditore të raportojë në DKA-rastet e evidentuara dhe kontaktet e familjeve përkatëse.

Udhëtimi për në institucionin arsimor

Gjatë udhëtimit për në institucionin arsimor përkatës, rregullat e sjelljes të specifikuar nga ISHKPK dhe MASH zbatohen si në institucionet publike, ashtu edhe në ato private:



Mbajtja e distancës së sigurtë prej të paktën 1.5 m nga njerëzit e tjerë



Ndalesa e transportit të bëhet në hapësira ku nxënësit mund të hypin dhe zbresin duke respektuar distancën 1.5 m.



Secili nxënës duhet të respektojë strikt orarin e vendosur nga shkolla me qëllim të shmangies se grumbullimit të nxënësve në të njëjtën kohë.

Rregullat në oborrin e shkollës



Prindërit e fëmijëve të moshës parashkollore dhe arsimit fillor ia dorëzojnë fëmijën e tyre stafit të përcaktuar te pikat e shenjëzuara.



Prindërit nuk kanë të drejtë të hyjnë në ambientet e brendshme të shkollës.



Në çdo rast duhet të shmanget grumbullimi i nxënësve kur të arrijnë në oborrin e shkollës. Varësisht nga numri i nxënësve, shkollat përgatisin orarin e hyrjes në objekt në mënyrë që të shmanget grumbullimi I nxënësve



Nëse disa nxënës arrijnë në institucionin arsimor në të njëjtën kohë, duhet të sigurohet një sistem kontrolli në mënyrë që të sigurohet distanca prej së paku 1.5 m.



Të shmanget frekuentimi i hapësirave të mbyllura përreth shkollës (lokale, dyqanet, kafiteritë etj.)



Shkollat duhet të shenjëzojnë hapësirat para hyrjes në shkollë në mënyrë që të sigurohet distanca prej së paku 1.5 m.



Çdo person që ka të drejtë të hyjë dhe që hyn në institucion arsimor, duhet të vendosë maskën mbrojtëse sipas etiketës (mbulohet goja dhe hunda).



Një person jashtë shkollës mund të hyjë në ndërtesë vetëm në raste të veçanta, gjithmonë duke respektuar masat mbrojtëse.

Matja e temperaturës

Secila shkollë duhet të ketë termometër për matje të temperaturës dhe të angazhojë një person përgjegjës për matjen e temperaturës së nxënësve dhe të personelit të shkollës.

Secilit nxënës si dhe personelit të shkollës duhet t'i bëhet matja e temperaturës përmes termometrit laserik çdo ditë.



Rregullat brenda shkollës

Në hyrje të shkollës, hyrje të korridoreve dhe në çdo klasë të vendosen materialet /posterët informues për masat mbrojtëse anti COVID-19 (etiketa e larjes së duarve, etiketa e vendosjes së maskës, etiketa e kollitjes dhe teshtimat me mbrojtje)

Protokolli dhe masat anti COVID-19, t'u shpërndahen ose të paraqiten në hapësirë të dukshme
Dyert e klasave të hapen dhe mbyllen nga mësimdhënësi. Nxënësit të udhëzohen mos të prekin dyert dhe dritaret




Lani duart!

Çdo person duhet të lajë duart e tij me ujë dhe sapun të lëngshëm menjëherë pas hyrjes në institucion (të paktën 30 sekonda, temperatura e ujit nuk ka rëndësi). Përndryshe mund të përdoren edhe dezinfektues të duarve. Dezinfektimi i duarve është gjithashtu i përshtatshëm për fëmijët. Sidoqoftë, dezinfektuesi i duarve duhet të jetë i qasshëm për të gjithë fëmijët/nxënësit dhe duhet të përdoret nënmbikqyrjen e stafit. Larja e plotë e duarve vlen jo vetëm pasi të keni hyrë në objekt, por duhet të bëhet disa herë gjatë gjithë ditës, posaçërisht kur teshtitni dhe kolliteni, para se të ushqeheni dhe pas përdorimit të tualeteve etj. Dezinfektimi i duarve duhet të bëhet pas çdo hyrje e dalje nga klasa.



Vendosni maskat dhe mbuloni gojen dhe hundën!

Të gjithë nxënësit dhe stafi që lëvizin nëpër ndërtesën e shkollës duhet të vendosin maskë gjatë gjithë qendrimit në institucion. Mësimdhënësit të vendosin edhe maskat mbrojtëse të fytyrës (faceshields).



Mbani distancën tuaj!

Mbani distancë të përhershme prej të paktën 1.5 m midis jush dhe një personi tjetër.



Mos prekni!

Mos prekni sytë, hundën ose gojën! Duart mund të marrin viruse dhe të transmetojnë virus.



Kushtojini vëmendje higjenës së frymëmarrjes!

Kur kolliteni ose kur teshtini, mbani gojën dhe hundën e mbuluar me bërrylat tuaj të mbledhur ose me një faculetë letre dhe hidhni menjëherë atë në shportën e mbeturinave.







Personat me simptoma!

Nëse paraqitet ndonje rast me simptoma të COVID-19, duhet të vendoset menjëherë në dhomë/klasë të veçantë e cila duhet të jetë e përcaktuar nga shkolla dhe të kontaktohet prindi.
Në bashkëpunim me prindin kontaktoni sherbimet shëndetësore/qendrën e mjekësise familjare më të afërt.
Sipas udhëzimeve të IKSHPK-së " Sapo personi me COVID-19 të largohet nga dhoma ku ai ishte i izoluar, dhoma nuk duhet të pastrohet ose të përdoret **për një orë** dhe gjatë kësaj kohe dera e dhomës duhet të mbetet e mbyllur".

- Sigurohuni që të gjitha sipërfaqet që kanë qenë të kontaktuara të pastrohen.

- Personi i caktuar për të pastruar dhomën (klasën) duhet të mbajë dorëza (nëse janë të disponueshme) dhe të pastrojë klasën e orenditë me deterxhent e pastaj me një dezinfektues ose pastrues të kombinuar që përmban një hipoklorit (tretësirë zbardhuese).

- Nuk kërkohet pastrim i veçantë për mure ose dysheme.

- Kushtojini vëmendje të veçantë sipërfaqeve të sheshta të prekura shpesh, shpinës së karrigeve, tavolinave, tabelës, etj.

- Pasi të përfundojë ky proces dhe të gjitha sipërfaqet të thahen, dhoma/klasa mund të përdoret përsëri.



Grupi i rrezikut!

Në rastet kur pjesëtarët e personelit apo nxënësit që kanë probleme shëndetësore kronike apo kanë në familje anëtar me probleme shëndëtsore me rrezikshmëri të lartë, ata duhet të qëndrojnë në shtëpi. Për këtë kategori të nxënësve, mësimet duhet të vazhdojnë të zhvillohen përmes mësimit në distancë.



Kontaktet me prindër dhe të tjerë!

Të gjitha kontaktet me prindër dhe të tjerë duhet të bëhen me telefon ose virtualisht nëse është e mundur.




Asnjë tubim!

Takimet dhe tubimet e ndryshme fizike duhet të shmangen medoemos.

Gjatë pushimit:


Dalja në pushime të jetë e organizuar në mënyrë që mos dalin të gjitha klasat në të njëjtën kohë. P.sh. klasat e para dalin jashtë ndërsa klasat tjera mbesin në klasa nëse është e mundur, rekomandohet që pushimet të bëhen jashtë në ambiente të hapura dhe të jenë më të gjata se zakonisht. Në çdo rast, dendësia në klasë, korridor, e rreshtit dhe përzierja me nxënësit nga klasa të tjera duhet të zvogëlohet. Pushimi të shfrytëzohet për ajrosje apo dezinfektim të klasës.

Rregullat në klasë




Mbani distancën tuaj

Gjatë gjithë kohës nxënësit dhe personeli duhet të sigurojnë një distancë sigurie prej së paku 1.5m. Në parim, nuk është gjithmonë e mundur të ruhet distanca, sidomos për fëmijet që janë në klasë parafillore, klasë të parë, apo edhe me nxënësit me nevoja të veçanta. Ne keto raste, sidomos gjatë shërbimeve të nevojshme mbështetëse (p.sh. ndihma gjate detyrave apo kërkesave tjera), ku nuk është e mundur të sigurohet/ruhet distanca fizike, kontakti me fytyrën në të njëjtin nivel të fytyrës duhet të shmanget dhe të përdoren dezinfektuesit sa më shpesh që është e mundur.
Mënyrat e rregullimit të bankave mësimore për të ruajtur distancën, janë dhënë në shtojcë, në fund të kësaj pjese të udhëzuesit.



Ajrosni klasën pas çdo orë mësimore!

Pas çdo ore mësimore, mësimdhënësi duhët të hap dritaret që të bëhët ajrosja e ambientit të klasës.Dritaret duhet të mbahen të hapura gjatë tërë kohës nëse këtë e lejojnë kushtet atmosferike. Të zgjaten pushimet në mes orëve të mësimit.



Shmangni ndarjen e objekteve/mjeteve konkretizuese mësimore!

Puna e përbashkët/loja me objekte apo mjete konkretizuese duhet të shmanget. Kjo vlen veçanërisht për nivelin e arsimit fillor. Artikujt në kontakt me pështymën ose trupin (p.sh. teshtitja) duhet të dezinfektohen menjëherë dhe pastrohen rregullisht me preparatet e rekomanduara nga IKSHPK-ja.



Përdorimi i materialeve në mësim. Gjithmonë me larje të duarve!

Kur përdorni materiale dhe pajisje të riciklueshme dhe mjete me të cilat punojnë disa nxënës, nxënësit duhet të lajnë duart para dhe pas përdorimit të tyre.

Çdo nxënës/e duhet të kujdeset personalisht për pastërtinë e bankës ku është i/e ulur.

Rregullat në sallen e mësimdhënësve

Numri i lejuar i personave që mund të jenë të pranishëm në sallën e mësimdhënësve në të njëjtën kohë, përcaktohet nga menaxhmenti duke marrë parasysh hapësirën e sallës dhe respektimin e distancës 1.5m dhe mbajtjen e maskave. Nëse është e nevojshme dhe e mundur, klasat apo kabinetet tjera duhet të përshtaten si hapësira pune për mësimdhënësit.

Mbledhjet dhe takimet mund të mbahen në mënyrë virtuale, në mënyrë që të shmanget pjesëmarrja jo e domosdoshme fizike.

Rregullat për personelin e shkollës



Mbrojtja e gojës dhe hundës është e detyrueshme.



Uniformat duhet të lahen një herë në ditë (të paktën 60 gradë).



Dezinfektuesit e duarve duhet të përdoren rregullisht.



Sipërfaqet / tavolinat duhet të pastrohen rregullisht me dezinfektues sipërfaqësor.



Shkolla duhet të sigurojë që të respektohet distanca e caktuar e sigurisë prej të paktën 1.5m.

Për shkollat që ofrojnë ushqim duhet të specifikohet se kush mund të jetë në të njëjtën kohë duke shërbyer ushqim ose në dhomën e ngrënies.


Për shkollat me kuzhina/bufe, pastrimi i zonave të ngrënies duhet të koordinohet me planin e pastrimit të shkollës.

Masat higjienike në ndërtesë

- Të gjitha nyjet sanitare duhet të jenë të pajisura me ujë të rrjedhshëm dhe me sapun të mjaftueshëm.
- Të gjitha hapësirat/ klasat duhet të ajrosen për të paktën pesë minuta pas çdo ore mesimore.
- Personeli teknik duhet të informohet me udhëzuesin dhe të ndjek masat dhe rregullat e përcaktuara.
- Të behet plani i pastrimit, gjithashtu duhet të bëhet një listë se kur dhe nga kush është kryer pastrimi.
- Të paktën një here në ditë duhet të bëhet pastrimi i plotë i të gjitha hapësirave në të cilat janë vendosur nxënësit, personeli pedagogjik dhe administrativ. Kur shfrytëzohen hapësirat, siç janë sallat e edukatës fizike, menjëherë pas përdorimit duhet të dezinfektohen. Koshat e plehrave duhet të zbrazen çdo pushim pasi të kenë dalur nxënësit.
- Dezinfektimi/pastrimi i sipërfaqeve ose hapësirave që frekuentohen nga numri më i madh i personelit dhe nxënësve duhet të kryhet disa herë në ditë (p.sh. dorezat e dyerve, çelësat e dritës, tastierat dhe minjtë e kompjuterit).
- Dezinfektuesit e duarve mbahen nën kujdestarinë e mësuesve përkatës dhe përdoren vetëm nën mbikëqyrjen e tyre.

TRAJNIMET E PARAPARA PËR ZBATIMIN E PROTOKOLLIT DHE TË UDHËZUESIT


Trajnimet adekuate për të gjithë akterët (DKA, drejtorët, inspektorët, mësimdhënësit dhe nxënësit) janë të parapara nga MASH dhe partnerët. Ato do të mbahen në formatin virtual dhe DKA-të do të njoftohen me kohë për orarin e trajnimeve .
Për detaje të tjera më të hollësishme për organizimin e vitit të ri shkollor 2020/2021, mbështetuni në udhëzuesin e përgjithshëm të MASH



SKEMA A

Klasa është riorganizuar duke marrë parasysh dimensionet mesatare të klasave.

Në raport zig-zak sigurohet distancë mes ulseve të secilit nxënës. Kjo klasë ka kapacitet për 15 nxënës, në rast se klasa të tjera kanë dimensione më të mëdha ather riorganizimi mund të bëhet edhe për 20 nxënës në total.



SKEMA B

Klasë për 10 nxënës.

E përshtatshme për klasa me dimensione të vogla, mesatare dhe ato të mëdha.

Këto klasa kanë hapësirë të mjaftueshme për të arritur distancë sociale mes nxënësve.

3.

ORGANIZIMI I VITIT SHKOLLOR DHE I SHKOLLËS, PËRKRAHJA E NXËNËSVE SIPAS SKENARËVE A, B DHE C





3. ORGANIZIMI I VITIT SHKOLLOR DHE I SHKOLLËS, PËRKRAHJA E NXËNËSVE SIPAS SKENARËVE A, B DHE C

Viti shkollor 2020/2021 nuk do të jetë vit i zakonshëm shkollor, andaj të gjithë akterët e përfshirë më arsimin parauniversitar duhet të mobilizohen dhe të planifikojnë veprimet përkatëse sipas të tre skenarëve të mundshëm, varësisht nga niveli i arsimit.
Me këtë dokument planifikohen tre skenarë dhe mbetet që MASH dhe Komunat të aprovojnë skenarët,varësisht prej situatës epidemiologjike në vend dhe kushteve specifike të institucioneve parashkollore/shkollave.

Deri më **20 Gusht 2020,** shkollat duhet të kenë të gatshëm një plan veprimi organizativ, së paku për gjysmë-vjetorin e parë të vitit shkollor 2020/21 për të tre skenarët.

Aplikimi i Skenarëve:

SKENARI **A**

(Niveli i rrezikshmërisë i ulët)

MËSIMI ME PREZENCË NË INSTITUCION PARASHKOLLOR/SHKOLLË-ME MASAT PARANDALUESE



Rikthimi në institucion parashkollor/shkollë me masa për siguri dhe shëndet, me grupe të vogla prej 15-20 nxënësve dhe protokoll për COVID-19 dhe raportim të rregullt të mungesave të raportuara të ndërlidhura me COVID-19.

SKENARI **B**

(Niveli i rrezikshëmirisë i mesëm)

RIKTHIM I PJESSHËM ME MËSIM TË KOMBINUAR - PREZENCË DHE MËSIM NË DISTANCË



Prioritet Klasat 1-5
Numri maksimal në klasë: 10 persona
Orar i shkurtuar
Mësim plotësues online

SKENARI **C**

(Niveli i rrezikshmërisë i lartë)

MËSIMI NË DISTANCË



TV e-mësimi
Përdorimi i platformave për e-mësim
Kontakti i rregullt më mësues, kujdestar klase, mësues lëndor,

Me rëndësi:



Skenarët A, B dhe C për organizimin e mësimit për vitin e ri shkollor 2020/2021 janë në funksion të realizimit të parimeve dhe qëllimeve kryesore të Kornizës kurrikulare të arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës.

Skenarët përcaktohen sipas prioriteteve dhe nivelit të rrezikshmërisë sidhe kushteve të institucionit parashkollor/shkollës.

Gjatë gjithë kohës, mësimdhënësit, nxënësit, prindërit dhe personeli i institucionit parashkollor/shkollës, DKA dhe MASHT duhet të praktikojnë masat e përcaktuara të mbrojtjes nga infeksioni dhe masat e higjienës.

Palët të cilët janë të në proces të organizimit të mësimit si: MASH,DKA, Shkolla, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit, duhet të informohen me kohë për të gjitha aktivitet dhe veprimet konkrete sipas secilit skenar. Përgatija ndihmon që sapo të krijohen kushtet, nxënësit e të gjitha niveleve të vazhdojnë shkollimin në objektet shkollore.

Shkolla është institucioni kyesor që organizon mësimin, ndërkaq drejtorët e shkollave dhe mësimdhënësit duhet të mundësojnë kushte për të nxënit atraktiv, zhvillim të shkathtësive dhe arritje të kompetencave kryesore të Kornizës kurrikulare të Kosovës (KKK).

Për nivelin e edukimit parashkollor- përshkak të specifikave që ka ky nivel edukimi, janë planifikuar vetëm dy skenare: Skenar A dhe C- të specifikuar në udhëzuesin të bashkangjitur në shtojcë.

Prioritet

Kthimi mundësisht sa më i shpejtë në çerdhe dhe shkolla:, sidomos për nxënësit e klasës 1 dhe 6, e pastaj edhe për nivelin 1-5 (Skenari 1 dhe 2)
Përgatitja e shkollave për mësimin në distancë: e-mësimi dhe tv-njësitë mësimore, platformat dhe trajnimet për mësimdhënësit (skenari 1, 2 dhe 3)

Në vijim do të paraqiten skenarët për nivelet e caktuara të arsimit me referencat dhe anekset shtesë sipas nevojës.

Në vijim shpjegohen konceptet kryesore të cilat mund të jenë të reja për vendimmarrësit, opinionin publik, ose prindërit.

e-Mësimi: është çdo formë e mësimit (elektronik) që ka për bazë internetin si medium i shpërndarjes së informatës dhe për komunikim. Ky është koncepti më i gjerë i formave të mësimit të bazuar në internet dhe përfshinë format e tjera të shpjeguara në vijim.

Mësimi online: është mësimi dhe ndërveprimi i mësimdhënësit me nxënësin në kohë reale duke përdorur internetin ose forma të tjera të avancuara të komunikimit (platforma dhe aplikacione të ndryshme si zoom, google meet, google classroom, microsoft teams, e të tjera). Kjo formë e mësimit mundëson më shumë ndërveprim dhe komunikim dykahor ne mës të nxënësve dhe mësimdhënësve. Kjo formë e mësimit do të aplikohet në të gjitha nivelet e arsimit në Kosovë.

Mësimi në distancë: nënkupton forma të ndryshme të përgatitjes, hartimit dhe shpërndarjes së materialeve mësimore dhe të vlerësimit të dijes së nxënësit e të studentit. Kjo mund të realizohet nëpërmjet të formave më të ndryshme, si për shembull me televizion (mësimi në RTK gjatë pandemisë COVID 2020), në platforma si you-tube (mësimi gjatë Pandemisë COVID 19 në vitin 2020), me radio, me postë (formë paksa më e vjetruar por e përdorur gjerësisht gjatë shekullit 20) e të tjera.

Mësimi i kombinuar (blended learning): është formë e mësimit që kombinon elemente të e-mësimit por edhe të mësimit në objekte fizike me një pjesëmarrje relativisht të balancuar të të dyja formave të të mësuarit.

Mësimi praktik - të gjitha format e mësimit dhe lëndët profesionale për të cilat është e domosdoshme të realizohet edhe mësim praktik në shkollë, në laborator, në punëtori, ose në ndërmarrje / institucione. Një pjesë e mësimit praktik do të zhvillohet edhe në formë të mësimit të digjitalizuar.

Format e e-mësimit sipas niveleve dhe shërbimeve arsimore:

Edukimi në fëmijërinë e hershme (edukimi parashkollor)

Të përgjithshme

Institucionet parashkollore për edukimin e fëmijëve në moshën e hershme, janë unike në qasjen e tyre edukative dhe janë ndër të parat që janë rihapur edhe gjatë periudhës së pandemisë.

Duke patur parasysh rolin që kanë institucionet parashkollore për të mbështetur jo vetëm fëmijët, por edhe prindërit/kujdesarët ligjor për t'u rikthyer në punë, lehtësimi i masave të izolimit nënkupton gjithashtu se fëmijët e vegjël do të kenë nevojë urgjente për kujdes institucional, pasi prindërit/kujdestarët ligjor kthehen në vendet e tyre të punës.

Në këtë përgjigjie MASH, është organizuar në bashkëpunim me donatorët dhe me komunitetin shëndetësor e edukativ, në hartimin e planit të veprimit të punës së institucioneve parashkollore të cilat veprojnë në Republikën e Kosovës për realizim të veprimtarisë edukative për të gjitha institucionet parashkollore, të cilave ato duhet t'u përmbahen, pa dallim.

Zbatimi i Kornizës kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore Aplikohen standardet e Zhvillimit dhe të Mësuarit në Fëmijërinë e Hershme, kurrikulën bërthamë për moshën 5-6 vjeç të fëmijëve.

SKENARI **A**

KTHIMI I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE

(Mësimi në grupe me më së shumti 15-20 nxënës, në distancë prej së paku 1,5 - 2m nga njëri tjetri)



Ky skenar kërkon që grupet e fëmijëve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient me distancë nga 1,5 m deri në 2m, brenda mundësive të respektohet distanca fizike, duke pasur parasysh moshën e fëmijëve.

Orari

Institucionet parashkollore fillojnë punën duke respektuar masat e përcaktuara në këtë udhëzues dhe sipas planit të veprimit Edukimi në Fëmijërinë e Hershme.[12]

Udhëzime Metodologjike

Sugjerohet që nëse është e mundur të zhvillohen aktivitete në ambientin e jashtëm duke pasuruar përvojat mësimore me aktivitetin fizik në natyrë (lojëra, vallëzim, sport, etj).

[12] Plani i Veprimit – Gusht 2020 - Edukimi në Fëmijërinë e Hershme (Edukimi parashkollor)


Përderisa fëmijët ballafaqohen me pandeminë, edukatorët mund të përdorin praktika pedagogjike kreative për të siguruar përvojat e këndshme të të mësuarit rreth situatës së pandemisë (për shembull, ndërtimi i mësimit bazuar në projekte mbi përvojën e fëmijëve me pandeminë; përdorimi i lojërave imagjinare për të ndihmuar fëmijët të përballen me stresin dhe për të promovuar qëndrueshmërinë; përdorimi i momenteve të të mësuarit për të ndihmuar fëmijët të mësojnë në lidhje me pandeminë dhe rolin e tyre në sigurimin e shëndetit publik).
Gjatë gjithë kohës sugjerohet të balancohen aktivitetet e të nxënit individual me ndërveprime në grupe të vogla dhe praktikim të vazhdueshëm të higjienës personale dhe të ambientit.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Varësisht prej formës se operimit në institucione parashkollore apo në distancë,fëmijët me nevoja të veçanta të moshës 0-6 vjeç mund të përdorin programin **''Mësimdhënia me fusha të aktiviteteve''** e cila është specifike për këto grupmosha. Programi gjendet në Platformën Arsimigjithëperfshirës.net ku për secilën fushë janë të zbërthyera aktivitetet të cilat mund të përdoren për të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta. Po ashtu aktivitetet janë të përshtatshme dhe të modifikuara edhe për prindërit. Secila fushë ka aktivitetet konkrete të shoqëruara me video, fotografi dhe materiale shtese për ushtrime specifike për fëmijët. Programi ka edhe format e planifikimit dhe vlerësimit të progresit të fëmijës hap pas hapi. Qendrat burimore do të ofrojnë takime informative me edukatoret dhe prindërit për të marrë me shumë informacione rreth përdorimit. Ju lutem referohuni në platforme apo udhëzues për të marrë informacionet për kontaktet e qendrave burimore.

SKENARI C

MËSIMI NË DISTANCË I FËMIJËVE NË INSTITUCIONET PARASHKOLLORE



Në rast të nivelit të rrezikshmërisë së lartë dhe vendimit për mbylljen e çerdheve, realizohet Edukimi I hershëm online, përmes platformës Edukimit në Distancë dhe transmetimit të përmbajtjeve edukative në Radio Televizionin e Kosovës

Platforma në Përdorim

Në shumë shtete, edukimi në distancë për edukimin parashkollor, nuk ka qenë i mundur, ndërsa në Kosovë, Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, me ndihmën e Partnerëve si UNICEF-i dhe Save the Children, më 15 prill 2020, ka lansuar platfomën Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç. Kjo platformë u krijua që të jetë pranë prindërve\kujdestarëve ligjor, edukatorëve, në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët në kushte shtëpie.
Platforma është e qasshme përmes uebfaqes së MASH në gjuhën shqipe, serbe, boshnjake dhe turke në vegzën https://edukimihershem.rks-gov.net/

Udhëzime Metodologjike

Platforma mundëson realizimin e aktiviteteve me fëmijë në kushte të mbylljes totale, kur edhe prindërit gjenden në shtëpi. Prindërit mund të realizojnë aktivitetet ditore, javore dhe mujore si dhe të përkrahin fëmijët me materialet mbështetëse duke mundësuar dërgimin dhe shikimin e videove dhe fotografive si dhe qasjen në lojëra për këtë grupmoshë të aprovuara nga MASH. Poashtu prindërit kanë udhëzues dhe informacione për secilën moshë[13] si dhe manualin për përdorimin e platformës.[14]

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi i fëmijëve në vitet e fëmijërisë së hershme është relativisht sfidues edhe në normalitet, pasi është periudha kur normat e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve janë më të larta se në të gjitha fazat e tjera. Rritja është e shpejtë, episodike dhe e ndikuar shumë nga mbështetja e mjedisit: edukimi i prindërve, kujdesi cilësor, ambienti dhe stimulimi i zhvillimit dhe të nxënit.

Vleresimi i femijëve në moshën e hershme realizohet përmes përshkrimit që tregon nivelin e arritjes se rezultateve të të nxënit dhe raportohet me komente konstruktive që motivojnë dhe orientojnë përparimin e fëmijëve. Udhëzimet specifike të vlerësimit për këtë nivel edukimi do të ofrohen në një dokument të veçantë.

Dokumentacioni pedagogjik për Edukimin parashkollor për vitin 2020-2021

Për vitin edukativ\shkollor 2020-2021, është përgatitur dokumentacioni pedagogjik si vijon:

- Libri i Punës Edukative nga 9 muaj -5 vjeç
- Ditari i Klasës Parafillore
- Libri Amë për edukimin parashkollor
- Në proces - hartimi i Certifikatës së Parashkollorit (do të jetë e gatshme para përfunditmit të vitit edukativ\shkollor).

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Varësisht prej formës se operimit në institucione parashkollore apo në distancë,fëmijët me nevoja të veçanta të moshës 0-6 vjeç, mund të përdorin programin **"Mësimdhënia me fusha të aktiviteteve"** e cila është specifike për këto grupmosha. Programi gjendet në Platformën Arsimigjithëperfshirës.net ku për secilën fushë janë të zbërthyera aktivitetet të cilat mund të përdoren për të gjithë fëmijët me nevoja të veçanta. Po ashtu aktivitetet janë të përshtatshme dhe të modifikuara edhe për prindërit. Secila fushë ka aktivitetet konkrete të shoqëruara me video, fotografi dhe materiale shtesë për ushtrime specifike për fëmijët. Programi përmban edhe format e planifikimit dhe vlerësimit të progresit të fëmijës hap pas hapi. Qendrat burimore do të ofrojnë takime informative me edukatoret dhe prindërit për të marrë më shumë informacione rreth përdorimit. Ju lutem t'i referoheni platformës apo udhëzuesit për të marrë informacionet për kontaktet e qendrave burimore.

[13] https://edukimihershem.rks-gov.net/materiale-mbeshtetese/
[14] Manualipërpërdorimin e platformështtps://edukimihershem.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2020/06/Edukimi-ne-Distance-Instruksione-per-perdorim-te-Platformes.pdf

Arsimi fillor dhe arsimi i mesëm i ulët klasat 1-9

Të përgjithshme

Në shkollat e Kosovës, arsimi fillor dhe i mesëm i ulët zakonisht organizohen në një objekt shkollor, dhe si rrjedhojë, në shumicën e rasteve kemi shkolla me dy ndërrime.

Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 1-9

Planifikimi edhe për skenarin A bëhet sipas propozimit për reduktimin e përmbajtjeve për 25%.[15]

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore
Sipas Planit për e-Mësimin, përfshihen "shtatë fushat kurrikulare për të gjitha klasat 1-9", me "së paku mbi 75 % ose mbi ¾ e fondit të orëve", ku "të gjitha lëndët kryesore në e-Mësimi duhet të përfshihen me fond të plotë të orëve (përveç lëndëve që kanë mbi 5 orë në javë)" dhe duke zvogëluar fondin e orëve për 30% në lëndë të caktuara, të cilat për shkak të karakteristikave specifike janë të vështira të realizohen përmes mësimit në distancë (Thaqi, 2020,f.18).

SKENARI **A**

KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLË

(Mësimi në grupe me më së shumti 15-20 nxënës,
në distancë prej së paku 1,5 - 2m nga njëri tjetri)



Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m dhe me 15 -20 nxënës në klasë. Orari i propozuar i përgjithshëm për secilën klasë mund të gjendet tek shtojca 3 E-mësimi[16]
Varësisht nga numri i nxënësve në shkollë dhe në paralele, dhe m2 e klasës të përcaktohet orari në shkollë. Orari mund të realizohet si në vijim:
Një grup me nxënës prej 10-15 ose 15-20 që të mund të organizohet distanca . Këtu i jepet prioritet nivelit më të ulët të arsimit për të siguruar klasat.

Shembull: Klasat 1-5
Mësimi organizohet nga ora 12:00 -14:00

[15] Shtojca 2 E mësimi
[16] ORARI DITOR E JAVOR PËR KLASAT 1 – 9 eMËSIMI

Nese klasa ka 30 deri në 40 nxënës, mësimi organizohet me dy grupe
Grupi 1: 09:30-11:30
Grupi 2: 12:00-14:00

Udhëzime Metodologjike

Mësimi mbahet në mënyrë të zakonshme, duke praktikuar vazhdimisht mbajtjen e higjienës personale dhe pastërtisë së ambientit. Gjatë mësimit në shkollë mund të inkorporohen edhe aspektet e përdorimit të mjeteve digjitale dhe platformave për të përgatitur nxënësit për skenarët e tjerë. Mësimdhënësit mund të përdorin edhe videot në RTK për të zhvilluar njësi mësimore të shoqëruara me shpjegime shtesë dhe detyra në klasë. Në këtë mënyrë nxënësit do të përgatiten dhe familjarizohen me metodën e kombinuar kur ndërrojnë skenarët. Fokusi është te mirëqenja e fëmijëve, ndjekja e masave të shëndetit, socializimi në kushte të sigurta, identifikimi i problemeve në të nxënë dhe përkrahja e atyre që kanë më shumë nevojë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi bëhet në mënyrë të zakonshme, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta i kanë specifikat e tyre andaj kërkojnë qasje dhe punë individuale. Duke pasur parasysh që tek fëmija/nxënësi me nevoja të veçanta në shumicën e rasteve mësim-nxënia ne distancë përcjellët përmes prindit, është e rëndësishme që mësimdhënësit, prindërit/kujdestaret të ndërtojnë marrëdhënie pozitive, t'i motivojnë dhe inkurajojnë përpjekjet e fëmijës, të vëzhgojnë angazhimin dhe punën, të japin informacione e udhëzime të qarta, të shkurtëra dhe t'u japin kohë më tepër pasiqë për fëmijët me nevoja të veçanta kjo është thelbësore.

Secila shkolle dhe secili mësimdhënës që në klasë/grup ka fëmijë/nxënës me nevoja të veçanta, duhet të përfshijë fëmijën/ nxënësin në procesin mësimor me gjithë klasën/grupin por në rastet e caktuara të mbajë takime individuale në mënyre që fëmija të angazhohet dhe të përforcojë njohuritë dhe shkathtësitë e përcaktuara në Planin Individual të Arsimit (PIA).

Në shkollat ku janë të punësuar mësuesit mbështetës dhe asistentët duhet të ketë bashkëpunim të ngushtë me edukatorët/ mësuesin/ën e klasës apo mësimdhënësit lëndor. Kjo duhet të behet përmes planifikimit të përbashkët në mënyre që të koordinohen aktivitetet dhe intervenimet, t'a plotësojnë njëri- tjetrin, që përkrahja të

bëhet në mënyre të harmonizuar dhe me qëllimin e njëjte për të zhvilluar dhe për të rritur aftësitë dhe shkathtësitë e fëmijës në fushat e përcaktuara me PIA etj.

Edukatorët/mësimdhënësit, mësuesit mbështetës dhe asistentet duhet të kenë kontakte të rregullta me qendrat burimore me të afërta për të marrë përkrahje profesionale-pedagogjike bazuar në nevojat individuale të fëmijës. Gjithashtu të gjitha shkollat, edukatorët dhe mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë platformën asimigjithëpërfshires.net për t'u pajisur më material pedagogjikë të modifikuar dhe të personalizuar për nxënësit me nevoja të veçanta por edhe me materiale pedagogjike shtesë për mësimdhënës dhe prindër. Të gjitha shkollat duhet të njoftojnë prindërit e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta për platformën asimigjithëpërfshires.net e cila gjendet në kuadër të platformës E-mësimi në mënyrë që prindërit ta shfrytëzojnë atë.
Qendrat Burimore edhe në vitin shkollor 2020-2021 do të vazhdojnë me përkrahjen e shkollave të rregullta, do të ofrojnë mbështetje direkte për nxënësit me nevoja të veçanta, prindërit, mësuesit mbështetës, asistentët dhe mësimdhënësit e tjerë. Mësuesit udhëtues përmes rrjetit të qendrave burimore do të ofrojnë konsultime, këshilla, materiale praktike në baza ditore për mësuesit mbështetës, asistentët dhe prindërit.

Po ashtu përmes shërbimeve të mbështetjes do të hartojnë dhe adoptojnë materiale të përshtatshme të cilat do t'i ndajnë me prindërit për t'i aplikuar me fëmijët e tyre gjithnjë duke dhëne edhe këshilla konkrete për prindërit:

- **Si identifikohen nevojat e fëmijës?**
- **Cilat aftësi apo shkathtësi zhvillohen të fëmija?**
- **Si të zbërthehen aftësitë e fëmijëve?**
- **Si përdoren materialet?**
- **Si vlerësohet progresi?**

Për nxënësit me dëmtime në dëgjim- QBMK "Nënë Tereza" ofron mësim në distancë në gjuhën e shenjave për nxënësit e shurdhër, materiale didaktike përmes platformave të cekura më lartë në të gjithë vendin.

Për nxënësit me dëmtime në të pamur/të verbër- QBMK "Dr. Xheladin Deda" ofron mësim në distancë, materiale në Brail, tekste, materiale audio për nxënësit rezident në qendër dhe për të gjithë nxënësit e verbër dhe me të pamur të dobësuar në Kosovë.

Format e ofrimit të mësimit në distancë për fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta

Këshilla profesionale - Qendrat Burimore do të ofrojnë këshilla profesionale pedagogjike në mënyrë online. Qëllimi është t'ju ndihmojmë prindërve dhe mësimdhënësve në qasjen ndaj punës me fëmijë me nevoja të veçanta, forma dhe teknikat e punës në realizim të aktiviteteve-detyrave individuale, përdorimit të materialeve didaktike, zbërthimit të aftësive të fëmijës në hapa konkret etj.

Oraret e ofrimit të shërbimeve arsimore në distancë sipas qendrave burimore për shkollat e rregullta:

QBMK "Përparimi" në Prishtinë		
Orari i shërbimeve		Mënyra e kontaktimit
E hënë	13.00 - 15.00	Pasi të keni hapur vegzën https://www.facebook.com/qb.perparimi fillimisht në messenger të kësaj vegze shkruani kërkesën dhe nevojat tuaj për mbështetje profesionale. Më pas, në orarin e caktuar, ju do të merrni përgjigjen tuaj individualisht me tekst apo edhe përmes lidhjes direkte në messenger të qendrës
E martë	13.00 - 15.00	
E mërkurë	13.00 - 15.00	
E enjte	13.00 - 15.00	
Komunat që mbulon kjo qendër burimore	Prishtinë, Podujevë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Drenas, Kaçanik, Kamenicë, Gjilan, Ranillug, Partesh, Graçanicë, Shtime, Kllokot, Viti, Ferizaj dhe Novo-Bërdë	

QBMK "Lef Nosi " në Prizren		
Orari i shërbimeve		Mënyra e kontaktimit
E hënë	11.00 - 13.00	Pasi të keni hapur vegzën https://www.facebook.com/lef.nosi.7 fillimisht në messenger të kësajvegze shkruani kërkesën dhe nevojat tuaj për mbështetje profesionale. Më pas në orarin e caktuar ju do të merrni përgjigjen tuaj individualisht me tekst apo edhe përmes lidhjes direket në messenger të qendrës
E martë	11.00 - 13.00	
E mërkurë	11.00 - 13.00	
E enjte	11.00 - 13.00	
Komunat që mbulon kjo qendër burimore	Prizren, Dragash, Mamushe, Rahovec, Suhareke, Malishevë, Gjakovë, Deçan, Junik, Shtërpce.	

QBMK “Nënë Tereza” në Mitrovicë			
Orari i shërbimeve			Mënyra e kontaktimit
E hënë	11.00 - 13.00	Takime me prindër	Pasi të keni hapur vegzën https://www.facebook.com/qendraburimore fillimisht në messenger të këtij linku shkruani kërkesën dhe nevojat tuaj për mbështetje profesionale. Më pas në orarin e caktuar ju do të merrni përgjigjen tuaj individualisht me tekst apo edhe përmes lidhjes direket në messenger të qendrës
E martë	11.00 - 13.00	Takime me mësues mbështetës	
E mërkurë	11.00 - 13.00	Takime asistent	
E enjte	11.00 - 13.00	Takime me mësimdhënës të nxënësve me nevoja të veçanta.	
Komunat që mbulon kjo qendër burimore	Mitrovicë, Istog, Pejë, Skenderaj, Klinë, Vushtrri ,Leposaviç, Zveçan, Zobin Potok		

SKENARI **B**

(Niveli i rrezikshëmirisë i mesëm)

MËSIMI I KOMBINUAR
(PREZENCË DHE MËSIM NË DISTANCË)



Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m dhe me më së shumti10 nxënës në klasë.
Me zvogëlim të numrit të nxënësve në grup nevojitet edhe ndryshimi i orarit:
Orari mund të realizohet si në vijim:
Organizimi i mësimit me orar të shkurtuar: 1 orë në shkollë çdo ditë në kombinim me e-mësimin
Organizim i mësimit me rotacion duke ndarë grupin e plotë në tre ose katër pjesë dhe të caktohet një ditë në shkollë me secilin grup.

Udhëzime Metodologjike

Shkolla duhet të ketë të përcaktuar orarin e takimeve, platformën për kontaktin e rregullt me nxënës dhe dërgimin e detyrave dhe të përshtat orarin e kontaktit me Emësimin në TV.
Gjatë kontaktit fizik mbulohen çështjet më të rëndëshishme të cilat nxënësit mund të kenë pasur problem për ti kuptuar.Kontakti fizik poashtu shërben për t'i ndihmuar nxënësit për t'u famijlarizuar me metodat vituale, përdorimin e pajsijeve dhe mënyrën e dorëzimit të detyrave apo kërkimit të ndihmës nëse hasin në vështirësi. Mësimdhënësi mund të ndjek me nxënësit bashkë videoxhirimet dhe të zhvillojë aktivitete tjera, kjo sidomos është ë rendësishme për klasat 1-5. Mësimdhënësi poashtu mund të jep informacioine kthyese për çështjet që ka hasur në detyrat e nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënsit/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët /nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në procesin mësimor në çfarëdo lloj të kombinimit që bëhet në mënyre që ata të jenë prezent në shkollë me

klasën e tyre. E rëndësishme është që mësimdhënia të bëhet sipas objektivave të përcaktuara me PIA . Në shkollat ku ka mësues mbështetës apo asistent të punësuar duhet të behet një orar i takimeve/ punës individuale në shkollë apo në mënyrë online.

Shih udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

SKENARI **C**
(Rrezik i lartë)

MËSIMI NË DISTANCË



Ky Skenar parasheh që mësimi të organizohet plotësisht nga distanca. Përveç E mesimit TV, shkollat duhet të përdorin platforma të aprovuara nga DKA dhe MASHT për të mbajtur kontakt të rregullt me nxënës dhe për të dorëzuar detyra.
Për klasat 1-9 të përdoret udhëzuesi E-Mësimi[17].

Platforma në Përdorim

E mësimi për Klasën 1-9 organizohet në Kanalet e RTK-së dhe në Platformën Digjitale të MASH-it, n https://emesimi.rks-gov.net
Platforma përmban videoligjeratat për lëndët sipas orarit për klasat 1-9 të cilat mund të ndiqen në TV apo të shikohen në çfarëdo pajisje tjetër. Ato poashtu mund të vendosen nga mësimdhënësit në platformat tjera edukative e-mësimi si e google classroom, microsoft ose e-shkollori.
Platforma nuk zëvendëson rolin e shkollës dhe të mësimdhënësve, por ka qëllim gjithëpërfshirjen.

Udhëzime Metodologjike

Platforma E mësimi dhe video ligjeratat nuk mundësojnë komunikimin me mësimdhënësit dhe bashkëmoshatarët. E mësimi përdoret në kombinim me platforma tjera, kjo sidomos për marrjen e informatave tjera shtesë, komunikimit online dhe dorëzimit të detyrave dhe informatave kthyese. Mësimdhënësit mund të transformojnë materialet e tyre didaktike në materiale digjitale dhe të shfrytësojnë komunikimin online për shpjegime shtesë.
E-mesimi permes TVsë duhet të kombinohet me përdorimin e materialeve në platforma (online dhe offline), dhe interaktiviteti e bashkëpunimi në mes mësimdhënës/nxënës, dhe nxënës/nxënës, punë në grup dhe punë inidviduale. Poashtu, delegimi i detyrave apo zgjidhjes se problemeve mos të jete uniforme për te gjithë nxënësit. Mund të ndahën në grupe, ne dyshe ku secili i ka të ndryshme detyrat në formë projektesh/ zgjidhje problemesh. Kjo kërkon që mësimdhënësit tu përshtaten nevojave idividuale të nxënësve, dhe të krijojnë mundësi që ata të bashkëpunojnë me dhe mësojnë nga bashkëmoshatarët por edhe të regjistrohet çdo gjë nëpër të cilat kalon nxënësi.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenjen e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe përqëndrimi të jetë tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme

[17] eMësimi 2020-2021 përklasat 1-9

unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASHT.

Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Fëmijët/nxënësit me nevoja të veçanta në shumicën e rasteve nuk mund të përcjellin mësimet që transmetohen në RTK andaj mësimdhënësit, varësisht për llojit dheshkalles se aftësisë se kufizuara, duhet që mësimdhënien për keta nxënës t'a ofrojnë përmes platformave onlineme ç'rast fëmijën/ nxënësin me nevoja të veçanta e përfshijnë me gjithë klasën. Nëse përshkak të aftësisë se kufizuar ai nuk mund të marr pjesë bashkë me klasën, atëherë duhet të ofrohet përkrahje individuale duke bashkëpunuar ngushtë me prindërit/ kujdestarët, duke përgatitur aktivitetet konkrete të cilat mund merren nga Platfoma asrimigjitheperfshires.net apo të hartohen dhe modifikohen vet. Në rastet kur shkolla ka mësues mbështetës dhe asistent atëherë mësimdhënësit bashkëpunojnë dhe koordinohen se bashku për t'i mbështetur nxënësit me nevoja të veçanta. Në të gjitha rastet mësuesit klasor dhe mësimdhënësit lëndor janë bartësit e aktiviteteve dhe përgjegjës për realizimin e tyre.

Shih udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

Arsimi i mesëm i lartë - Gjimnazet klasat 10-12

Të përgjithshme


Gjimnazet në Kosovë kanë objektin e vet shkollor, me përjashtim të disa komunave në të cilat gjenden në një kampus me shkollat e tjera. Në shumicën e rasteve gjimnazet organizojnë mësimin në dy ndërrime.

Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 10-12

Planifikimi edhe për skenarin A bëhet sipas propozimit për reduktimin e përmbajtjeve për 25%.[18]

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare:

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore
Sipas Udhëzuesit të MASH[19] realizohet zbatimi i kufizuar në lëndët kryesore (gjuhë, matematikë, shkenca natyrore dhe lëndë shoqërore) varësisht nga tipi i gjimnazit. Për shembull, gjimnazet gjuhësore do të përqendroheshin në lëndët gjuhë, matematikë dhe gjuhët kryesore, ndërkaq gjimnazet shkencore do të përqendroheshin në gjuhë, matematikë dhe shkenca natyrore e të tjera sipas tipit të gjimnazit.Planet e detajizuara aprovohen nga divizioni i kurrikulave në MASH.



Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m dhe me 15 -20 nxënës në klasë. Orari i propozuar për shkollat profesionale mund të gjendet tek shtojca 5.[20]

Varësisht nga numri i nxënësve në shkollë dhe në klasë, dhe m2 e klasës të përcaktohet orari në shkollë. Orari mund të realizohet si në vijim:

Një grup me nxënës prej 10-15 ose 15-20 që të mund të organizohet distanca .

Shembull: Klasat 12

Mësimi organizohet nga ora 12:00 -14:00

[18] Shtojca 2 E mësimi
[19] UDHËZIME PËR DREJTORITË KOMUNALE TË ARSIMIT PËR REALIZIMIN E MËSIMIT ONLINE PËR SHKOLLAT E MESME TË LARTA (SHML) https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-shml-mashti_1.pdf
[20] Të bëhet Shtojca

Nëse klasa ka 30 deri në 40 nxënës, mësimi organizohet me dy grupe
Grupi 1: 12:00-15:00
Grup1 2: 15:30-18:30

Udhëzime Metodologjike

Mësimi mbahet në mënyrë të zakonshme, duke praktikuar vazhdimisht mbajtjen e higjienës personale dhe pastërtisë së ambientit. Gjatë mësimit në shkollë, inkorporohen edhe aspektet e përdorimit të mjeteve digjitale, mësimit të vetë drejtuar, projektet dhe përdorimi i platformave për të përgatitur nxënësit për skenarët e tjerë. Mësimdhënësit mund të përdorin edhe videot nga platforma tjera si Khan Academy, Natioal Geographics, History Channel, për zhvilluar njësi mësimore të shoqëruar me shpjegime shtesë dhe detyra në klasë. Në këtë mënyrë nxënësit do të përgatiten dhe do të familjarizohen me metodën e kombinuar kur ndërrojnë skenarët. Përqëndrimi është tek mirëqenia e nxënësve dhe krijimi i shprehive për vetëdrejtim, ndjekja e masave të shëndetit, socializimi në kushte të sigurta, identifikimi i problemeve në të nxënë dhe përkrahja e atyre që kanë më shumë nevojë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi bëhet në mënyrë të zakonshme, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat dhe të mbahet përqëndrimi tek arritja e rezultateve bazë. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASHT.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në procesin mësimor pavarësisht formës së organizimit të mësimit. Me rëndësi është puna individuale, sidomos nëse nxënësi ka PIA. Materialet dhe aktivitetet mësimore mund të shfrytëzohen nga Platforma arsimigjitheperfshires.net apo të hartohen dhe modifikohen vet.
Duke pasur parasysh që në ketë nivel nuk ka asistent atëherë shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informacione të mëtejme referoju udhëzuesit.

Nxënësit me nevoja të veçanta duhet të jenë të përfshirë në procesin mësimor, pra të jenë prezent në shkollë me klasën e tyre. E rëndësishme është që mësimdhënia të behet sipas objektivave të përcaktuara me PIA, apo sipas planit mësimor. Duke pasur parasysh që në ketë nivel nuk ka asistent atëherë shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informacione të mëtejmë referoju udhëzuesit.*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

SKENARI **B**

(Niveli i rrezikshëmirisë i mesëm)

MËSIMI I KOMBINUAR
(PREZENCË DHE MËSIM NË DISTANCË)



Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m dhe me më së shumti10 nxënës në klasë.
Me zvogëlim të numrit të nxënësve në grup nevojitet edhe ndryshimi i orarit:
Orari mund të realizohet si në vijim:
Organizimi i mësimit me orar të shkurtuar: 1 orë në shkollë çdo ditë në kombinim me e-mësimin.
Organizim i mësimit me rotacion duke ndarë grupin e plotë në tre ose katër pjesë dhe të caktohet një ditë në shkollë me secilin grup.

Udhëzime Metodologjike

Shkolla duhet të ketë të caktuar orarin e takimeve, platformën për kontaktin e rregullt me nxënës dhe dërgimin e detyrave.
Gjatë kontaktit fizik mbulohen çështjet më të rëndësishme, të cilat nxënësit mund të kenë pasur problem për 'ti kuptuar ose sqarimit të projekteve. Kontakti fizik poashtu shërben për t'i ndihmuar nxënësit për t'u famijlarizuar me metodat online, përdorimin e pajisjeve dhe mënyrën e dorëzimit të detyrave apo kërkimit të ndihmës nëse hasin në vështirësi. Mësimdhënësi poashtu mund të japë informcione kthyese për çështjet që ka hasur në detyrat e nxënësve.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe të mbahet përqëndrimi tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta


Nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në procesin mësimor pavarësisht formës se organizimit të mësimit. Me rendësi është puna individuale, sidomos nëse nxënësi ka PIA. Materialet dhe aktivitetet mësimore mund të shfrytëzohen nga Platforma arsimigjitheperfshires.net apo të hartohen dhe modifikohen vet.
Duke pasur parasysh që në këtë nivel nuk ka asistent atëherë shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore për të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informatat të mëtejmë referoju udhëzuesit*.

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

SKENARI **C**

(Rrezik i lartë)

MËSIMI NË DISTANCË



Ky Skenar parasheh që mësimi të organizohet plotësisht nga distanca. Gjimnazet duhet të perdorin platforma të aprovuara nga DKA dhe MASH për të mbajtur kontakt të rregullt me nxënës dhe për të dorëzuar detyra.

Platforma në Përdorim

Rekomandohet një platformë unike për shkollë, sikur google suite for education ose Microsoft. Shihni në kapitullin 5 përshkrimet e platformave.

Pasi gjimnazet nuk kanë platformë unike dhe materiale të krijuara në mënyrë virtuale, sugjerohen hapat emergjent për përzgjedhjen e platformave:

- Të caktohet Platforma
- Të përshkruhen mundësitë dhe qasja
- Të jepen udhëzuesit

Udhëzime Metodologjike

Gjimnazet nuk kanë qasje në video-ligjerata e Emësimit. Grupmosha dhe niveli i njohurive të përgjithshme sidhe të gjuhëve të huaja, mundëson aplikimin e platformave më të qëndrueshme në të cilat mësimdhënësit vendosin materialet e tyre dhe organizojnë mësimin.

Përshkak se platformat digjitale kërkojnë vetë-drejtimin, është e domosdoshme përgatitja me kohë. Në platformë mësimdhënësit mund të vendosin burime PDF, DOC, EXCEL, Poëerpoint, video, uebfaqe, vegza në platofrma të tjera, fjalorë si dhe të përdorin aplikacione të integruara si maps, wiki, quize etj. Poashtu në platformë mund të organizohet kalendari shkollor, oraret lëndore në formë automatike si dhe të realizohet komunikimi online i sinkronizuar. Mësimdhënësit mund të postojnë detyrat dhe nxënësit të dërgojnë detyrat. Mësimdhënësit mund të transformojnë materialet e tyre didaktike në materiale digjitale dhe të shfrytësojnë komunikimin online për shpjegime shtesë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe të mbahet përqëndrimi tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe për dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me nevoja të veçanta, për shkak të llojit dhe shkallës aftësisë se kufizuar, mund të mos kenë mundësi të marrin pjese në mësimin në distancë. Në këto raste mësimdhënësit duhet të kontaktojnë prindërit/kujdestarët dhe në bashkëpunim me ta, të ofrojnë përkrahjen e nxënësve për arritjen e rezultateve mësimore të përcaktuara në kurrikulë apo PIA . Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë platformën arsimigjitheperfshires.net apo të hartojnë dhe modifikojnë vet materialet. Në qoftë përshkak të aftësisë se kufizuar nxënësi nuk mund të marrë pjesë bashkë me klasën në mësimin online, atëherë duhet të ofrohet përkrahje individuale duke bashkëpunuar ngushtë me prindërit/ kujdestarët.

Duke pasur parasysh që në ketë nivel nuk ka asistent atëherë shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informacione të mëtejmë referoju udhëzuesit.*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

Arsimi i mesëm i lartë - Institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional, klasat 10 - 12

Të përgjithshme

Nxënësve të IAAP t'u jepet prioritet kthimi me mësim të rregullt në shkolla për shkak të specifikave që ka mësimi në këto institucione, ngaqë pjesa më e madhe e mësimit është mësim praktik dhe me vështirësi mund të realizohet në mënyrë online. Gjithashtu sugjerohet që në komunat në të cilat ka numër të vogël të rasteve të infeksioneve me COVID-19, IAAP të organizojnë mësim të rregullt në klasë, poashtu edhe për arsimin e të rriturve, duke respektuar masat e përcaktuara më lartë të shëndetit dhe sigurisë.
Udhëzuesi i vecantë i MASH për punën në shkollat profesionale dhe qendrat e komptencës, ka informacione më të hollësishme për organizimin e mësimit në arsimin profesional, në kushtet e pandemisë. [23]

Lëndët dhe fondi javor i orëve për klasat 10-12

Për klasat 10 – 12 në institucionet e arsimit dhe aftësimit profesional të mbahet mësim i rregullt sipas orarit të rregullt javor. Për shkak të ndarjes së nxënësve në grupe më të vogla duhet të shkurtohen orët mësimorë, ashtu që t'u mundësohet pjesëmarrja në mësimin e rregullt të gjithë nxënësve.Nëse numri i nxënësve në klasë është i madh mund të krijohet orar javor për grupe të ndara të nxënësve, ashtu që njëri grup i nxënësve mban mësim në kabinet/ punëtori, ndërsa grupi tjetër mësim praktik në klasë.
Lëndët të cilat nxënësit mund të dalin jashtë, si p.sh edukata fizike këshillohet që të mbahen në ambient të hapur duke respektuar distancën dhe masat e sigurisë.

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare

Zbatimi i Kornizës Kurrikulare: Kurrikula Bërthamë Programet Mësimore/ Lëndore
Të gjitha shkollat e arsimit parauniversitar duhet t'a zbatojnë kurrikulën të cilën e ka miratuar MASH, mirëpo implementimi duhet të bëhet përmes platformës digjitale, gjë e cila është e mundur dhe lehtë e zbatueshme. Tekstet shkollore mund të përdoren ne kopje fizike dhe digjitale. Dokumentacioni pedagogjik duhet ti dorëzohet fizik dhe digjital; platforma mundëson ruajtjen dhe evidentimin e pjesëmarrjes aktivitetit te nxënësit dhe vlerësimit mirëpo mësimdhënësit duhet te punojnë ne dokumentacionin pedagogjik të aprovuar nga MASH në dy versione digjital dhe fizik.

[23] https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/03/udhezime-per-drejtorite-komunale-te-arsimit-per-realizimin-e-mesimit-online-per-shkollat-e-mesme-te-larta-profesionale-shml-dhe-qendrat-e-kompetences-mashti_1.pdf

SKENARI **A**

KTHIMI I NXËNËSVE NË SHKOLLAT PROFESIONALE DHE QENDRAT E KOMPETENCËS KLASAT 10-12

(Mësimi në grupe me më së shumti 15-20 nxënës, në distancë prej së paku 1,5-2 m nga njëri tjetri. Numri i nxënësve në klasë varet nga madhësia e klasës apo kabinetit/ punëtorisë përkatëse në IAAP



Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m.

Varësisht nga numri i nxënësve në shkollë dhe në paralele, dhe m2 e klasës të përcaktohet orari në shkollë.

Një grup me nxënës prej 10-15 ose 15-20 që të mund të organizohet distanca.

Nëse klasa ka 30 deri në 40 nxënës, mësimi organizohet me dy grupe

Orari mund të realizohet si në vijim:

Grupi 1: 07:00-10:30

Grupi 2: 11:00-14:30

Grupi 3: 15:00 – 18:30

Udhëzime Metodologjike

Mësimi mbahet në mënyrë të zakonshme, duke praktikuar vazhdimisht mbajtjen e higjienës personale dhe të pastërtisë së ambientit. Gjatë mësimit në shkollë, inkorporohen edhe aspektet e përdorimit të mjeteve digjitale, mësimit të vetë drejtuar, projektet dhe përdorimi i platformave për të përgatitur nxënësit për skenarët e tjerë. Mësimdhënësit mund të përdorin edhe videot nga platforma tjera si Khan Academy, Natinoal Geographics, History Channel, për zhvilluar njësi mësimore të shoqëruar me shpjegime shtesë dhe detyra në klasë. Në këtë mënyrë nxënësit do të përgatiten dhe familjarizohen me metodën e kombinuar kur ndërrojnë skenarët. Përqëndrimi është tek mirëqenia e nxënësve dhe krijimi i shprehive për vetë-drejtim, ndjekja e masave të shëndetit, socializimi në kushte të sigurta, identifikimi i problemeve në të nxënë dhe përkrahja e atyre që kanë më shumë nevojë.

Udhëzime për vlerësim

Vlerësimi bëhet në mënyrë të zakonshme, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe të mbahet përqëndrimi tek arritja e rezultateve bazë. Udhëzimet e detajuara për vlerësim gjenden në udhëzuesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me nevoja të veçanta duhet të jenë të përfshirë në procesin mësimor pra të jenë prezent në shkollë me klasën e tyre. E rëndësishme është që mësimdhënia të

behet sipas objektivave të përcaktuara me PIA apo sipas planit mësimor. Duke pasur parasysh që në këtë nivel nuk ka asistent atëherë e shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informacione të mëtejmë referoju udhëzuesit.*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

SKENARI **B**

(Niveli i rrezikshëmirisë i mesëm)

MËSIMI I KOMBINUAR
(PREZENCË DHE MËSIM NË DISTANCË)



Në rast se numri i infeksioneve me COVID-19 përbën një rrezik mesatar, atëherë mësimi mund të organizohet në mënyrë të kombinuar në IAAP. Në rast se organizohet mësim i kombinuar, për IAAP ka përparësi mbajtja e lëndëve praktike në shkollë si dhe në kabinete/ punëtori, ndërsa përmes mësimit plotësues online mund të mbahen lëndët e përgjithshme dhe teorike.Gjithashtu përparësi t'u jepet nxënësve më të pa favorizuar dhe mbajtjes së mësimit plotësues.

Orari

Ky skenar kërkon që grupet e nxënësve që kthehen në shkollë të qëndrojnë në ambient të klasës me distancë nga 1,5 m deri në 2m dhe me më së shumti10 nxënës në klasë.
Organizimi i mësimit bëhet me orar të shkurtuar: 1-3 orë në shkollë çdo ditë në kombinim me mësimin online.
Organizim i mësimit bëhet me rotacion duke ndarë grupin e plotë në tre ose katër pjesë dhe të caktohet një ditë në shkollë me secilin grup, si dhe një ditë për nxënësit me vështirësi në nxënie.
Orari mund të realizohet si në vijim:
Grupi 1: 08:00-10:30
Grupi 2: 11:00-13:30
Grupi 3: 14:00 -16:30

Udhëzime Metodologjike

Shkolla duhet të ketë të përcaktuar orarin dhe lëndët e mësimit të rregullt në klasë si dhe orarin e mësimit online përmes platformës përkatëse. Pasiqë shkollat profesionale kanë specifika të veçanta për arsye se një pjesë e madhe e punës së tyre organizohet në mënyrë praktike, këshillohet që sidomos lëndët e praktikës profesionale të mbahen në shkollë ndërsa lëndët teorike përmes mësimit në distancë.Gjithashtu, gjatë kontaktit fizik mbulohen çështjet më të rëndësishme të cilat nxënësit mund të kenë pasur problem për ti kuptuar. Kontakti fizik poashtu shërben për t'i ndihmuar nxënësit për t'u familjarizuar me metodat virtuale, përdorimin e pajisjeve dhe mënyrën e dorëzimit të detyrave apo kërkimit të ndihmës nëse hasin në vështirësi.Mësimdhënësi po ashtu mund të japë informacione kthyese për çështjet që ka hasur në detyrat e nxënësve.

Niveli i arsimit të mesëm të lartë duhet të punojë për pjesën e mësimit në distancë përmes platformave si Microsoft Teams, ose të ngjashme, të cilat mundësojnë komunikimin video audio, interaktivitet, testim, vlerësim, monitorim dhe raportim.
Para fillimit të vitit të ri shkollor këshillohet që të bëhët trajnimi i mësimdhënësve për

përdorimin e platformës online si dhe për organizimin e mënyrë së mësimit në distancë ose të kombinuar. Për të përfshirë më lëhtë të gjithë mësimdhënësit dhe për një mbulueshmëri sa më të madhe rekomandohet trajnimi i 2-3 mësimdhënësve nga secila shkollë, të cilët pastaj trajnojnë dhe mbështesin kolegët e tyre në mënyrë virtuale. Në këtë grup duhet të përfshihen edhe mësimdhënësit e TIK ose lëndëve të tjera të ngjashme, për të cilët përdorim i platformave elektronike është më i lehtë.

Udhëzime për vleresim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenjen e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe të fokusohet tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzesin për vlerësim të aprovuar nga MASH.

Udhëzime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Nxënësit me nevoja të veçanta duhet të përfshihen në procesin mësimor pavarësisht formës se organizimit të mësimit. Por me rendësi është puna individuale sidomos nëse nxënësi ka PIA. Materialet dhe aktivitetet mësimore mund të shfrytëzohen nga platforma arsimigjitheperfshires.net apo të hartohen dhe modifikohen vete.
Duke pasur parasysh që në ketë nivel nuk ka asistent atëherë e shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore për të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar . Për informacione të mëtejmë referoju udhëzuesit.*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

SKENARI **C**

(Rrezik i lartë)

MËSIMI NË DISTANCË



Ky skenar parasheh që mësimi të organizohet nga distanca, ndërsa në shkollat profesionale mund të organizohet mësimi edhe më tej përmes platformave online. Paraprakisht është e nevojshme të bëhet trajnimi i mësimdhënësve për organizimin dhe planifikimin e mësimit në këtë formë.

Orari

Edhe nëse mësimit organizohet në të gjitha IAAP përmes mësimit në distancë, duhet të ketë një orar të përcaktuar javor të mësimit. Nxënësit dhe prindërit duhet të jenë të njoftuar paraprakisht me orarin javor, ashtu që të mund të përgatiten. Nxënësit përpos orëve të rregullta mësimore javore rekomandohet të kenë edhe orë konsultimi të caktuara me kujdestarin e klasës. Në këtë rast mund të shkurtohet përmbajtja lëndorë si dhe kohëzgjatja e orës mësimore, mirëpo është e rëndësishme që mësimi të mbahet për të gjitha lëndët.

Platforma në Përdorim

Niveli i arsimit të mesëm të lartë duhet të punojë për pjesën e mësimit në distancë përmes platformave si Microsoft Teams, ose të ngjashme, të cilat mundësojnë komunikimin video audio, interaktivitet, testim, vlerësim, monitorim dhe raportim. Nga niveli qendror duhet të merret vendimi për përdorimin e platformës së njëjtë nga të gjitha IAAP, sepse kjo gjë lehtëson trajnimin për përdorim dhe monitorimin e platformës.
Në disa shkolla profesionale gjatë kohës së pandemisë është përdorur MS Teams, Google, Zoom, si dhe Labster për shkenca aplikative dhe Autodesk Fusion 365 për punë laboratorike dhe praktike përmes realitetit online.
Deri me 15 Gusht të merren hapat urgjent në vijim:

- **Të caktohet Platforma**
- **Të përshkruhen mundësitë dhe qasja**
- **Të jepen udhëzuesit**

Udhëzime Metodologjike

Para fillimit të vitit të ri shkollor këshillohet që të behët trajnimi i mësimdhënësve për përdorimin e platformës online si dhe për organizimin e mënyrës së mësimit në distancë ose të kombinuar. Për të përfshirë më lehtë të gjithë mësimdhënësit dhe për një mbulueshmëri sa më të madhe rekomandohet trajnimi i 2-3 mësimdhënësve nga secila shkollë, të cilët pastaj trajnojnë dhe mbështesin kolegët e tyre në mënyrë virtuale. Në këtë grup duhet të përfshihen edhe mësimdhënësit e TIK ose lëndëve të tjera të ngjashme, për të cilët përdorim i platformave elektronike është më i lehtë.

Udhëzime për vleresim

Vlerësimi orientohet drejt platofrmave digjitale, duke pasur kujdes më shumë në mirëqenien e nxënësve dhe vështirësitë në nxënie. Të reduktohen detyrat, dhe të mbahet përqëndrimi tek arritja e rezultateve bazë. Sugjerohet përdorimi i një platforme unike për komunikim online me nxënësit/prindërit dhe për dorëzimin e detyrave. Udhëzimet për vlerësim janë detajuar në udhëzesin për vlerësim të aprovuar nga MASH. Sugjerohet të krijohet Portofolio e nxënësve- me detyrat, projektet etj. të dërguara nga nxënësit dhe të pranuara nga mësimdhënësi.

Udhezime specifike për nxënësit me nevoja të veçanta

Për shkak të llojit dhe shkallës aftësisë se kufizuar, nxënësit me nevoja të veçanta mund të mos kenë mundësi të marrin pjese në mësimin në distancë. Në këto raste mësimdhënësit duhet të kontaktojnë prindërit/kujdestarët dhe në bashkëpunim me ta ofrojnë përkrahjen e nxënësve për arritjen e rezultateve mësimore të përcaktuara kurrikul apo PIA. Mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë platformën arsimigjitheperfshires.net apo të hartojnë dhe të modifikojnë vet materialet. Nëse përshkak të aftësisë se kufizuar nxënësi nuk mund të marrë pjesë bashkë me klasën në mësimin online atëherë duhet të ofrohet përkrahje individuale duke bashkëpunuar ngushtë me prindërit/ kujdestaret.Duke pasur parasysh që në ketë nivel nuk ka asistent atëherë shkollat mund të kontaktojnë qendrat burimore për të marrë shërbime, këshilla dhe materiale profesionale specifike sipas llojit të aftësisë se kufizuar. Për informacione të mëtejmë referoju udhëzuesit.*

*https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/08/udhezues-per-perkrahjen-e-nxenesve-me-nevoja-te vecanta-gjate-mesimit-ne-distance-dhe-online-2020-2021-1.docx

4. ZBATIMI I KURIKULËS DHE UDHËZIMET METODOLOGJIKE

Zbatimi i dokumenteve kurrikulare dhe Plan-programeve mësimore /lëndore dhe orarit në kushte pandemie me COVID-19

Pa marrë parasysh se me cilin skenar do të punojnë shkollat, mësimdhënësit dhe menaxhmenti i shkollës duhet të kenë parasysh se edhe në kushte emergjente duhet të kemi parasysh qëllimet e arsimit paruniversitar të Kosovës, të përcaktuara si:

- **kultivimi i identitetit personal, kombëtar, i përkatësisë shtetërore e kulturore**
- **promovimi i vlerave të përgjithshme kulturore dhe qytetare**
- **zhvillimi i përgjegjësisë ndaj vetes, ndaj të tjerëve, ndaj shoqërisë dhe ndaj mjedisit**
- **aftësimi për jetë dhe për punë në kontekste të ndryshme shoqërore e kulturore**
- **zhvillimi i ndërmarrësisë dhe përdorimi i teknologjisë për zhvillim të qëndrueshëm**
- **aftësimi për mësim gjatë gjithë jetës.**

Objektivat e shkollës dhe të arsimit parauniversitar do të vazhdojnë të jenë të drejtuara edhe në kushte të emergjencës kah realizimi i kompetencave kryesore.[21] Arritja e këtyre kompetencave dhe rezultateve të të nxënit të fushës (RNF) dhe të lëndëve të caktuara (RNL) është e mundshme edhe me numër të reduktuar të njësive mësimore (deri në 80%) sipas një plani të mirëorganizuar mësimor (shih planin e propozuar në udhëzuesin për e-mësimin) dhe me qasjen e mësimit të integruar.

Pra edhe në kushtet e krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19, mësimdhënia duhet të jetë e orientuar kah zhvillimi sa më i plotë i të gjitha kompetencave në mënyrë të barabartë, pa anashkaluar ndonjërën prej tyre. Njësitë mësimore, detyrat, projektet dhe instrumentet e vlerësimit duhet të planifikohen dhe të realizohen mirë (në të 3 skenarët) si kontribut i drejtëpërdrejtë në zhvillimin apo arritjen e tyre.

Pavarësisht nga rëndësia e veçantë e të ashtuquajturave lëndë kyçe për individët, shoqërinë dhe ekonominë, është pikërisht trajtimi dhe tejkalimi i situatës aktuale veprim që kërkon edukim të plotë e gjithëpërfshirës, i cili në veçanti përfshin edhe çështjet ndërkurrikulare, (demokracinë, edukimin, media, barazinë gjinore, zhvillimin e qëndrueshëm, edukimin për jetë të shendetshme etj).

Kompetencat

Të përkujtojmë se 6 kompetencat kryesore të parapara që të zhvillohen në arsimin parauniversitar në Kosovë janë:

[21] Burimi: (KornizaKurrikulare e ArsimitParauniversitarneKosove -e rishikuar, 2016 fq17-18)

Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit

Komunikim i drejtë në gjuhën amtare; Komunikimi nëpërmjet gjuhëve të huaja; Të shprehurit kulturor nëpërmjet simboleve, shenjave dhe shprehjeve të tjera artistike; Komunikimi nëpërmjet teknologjisë informative; Angazhimi dhe kontributi për dialog produktiv; Respektimi i rregullave të komunikimit; Dhënia dhe pranimi i informacionit kthyes në mënyrë konstruktive; Shprehja e tolerancës dhe bashkëndjesisë në komunikim si dhe inicimi i veprimeve konstruktive.

Kompetenca e të menduarit (kritik dhe kreativ)

Kompetencat matematikore dhe kompetencat themelore në shkencë dhe në teknologji; Kompetencat digjitale; Të kuptuarit, të analizuarit, të gjykuarit, të sintetizuarit; Zhvillimi i mendimit abstrakt; Marrja e vendimeve të bazuara në informacione të verifikuara; Lidhja e vendimeve me pasojat; Vlerësimi dhe vetëvlerësimi; Zgjidhja e problemeve.

Kompetenca e të mësuarit

Mësimi për të mësuar/nxënë – vetorganizimi i të nxënit; Njohja, gjetja dhe shfrytëzimi i instrumenteve dhe metodave të të mësuarit/nxënit; Zotërimi i mirëfilltë i leximit, i shkrimit, i matematikës, i shkencës, i teknologjisë së informacionit e komunikimeve; Identifikimi dhe përpunimi i informacioneve në mënyrë tëpavarur, efektive dhe të përgjegjshme; Mësimi në ekip dhe shkëmbimi i përvojave pozitive.

Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis

Paraqitja më e mirë e vetvetes gjatë prezantimit duke transmentuar zotësitë që posedon; Punë e pavarur dhe si pjesë e ekipeve punuese; Organizim dhe udhëheqje e aktiviteteve mësimore dhe shoqërore; Dëshmim i shkathtësive ndërmarrëse, i njohurive për planifikim të punës, i shfrytëzimit racional të kohës; Zotërim i aftësive për menaxhim të konflikteve dhe vlerësim të rreziqeve ; Ndërmarrje e veprimeve të pavarura dhe të përgjegjshme; Angazhim për mbrojtjen dhe zhvillimin e mjedisit.

Kompetenca personale

Dëshmim i të njohurit të vetes dhe të tjerëve; Dëshmim i vetëbesimit; Menaxhim i emocioneve dhe i stresit;Shfaqje e bashkëndjesisë për të tjerët;Dëshmim i aftësive për të bërë jetë të shëndoshë; Bërja e zgjedhjeve të përgjegjshme për shëndetin personal; Kompetenca qytetare;Kompetenca të raporteve ndërpersonale, ndërkulturore dhe shoqërore; Mirëkuptim dhe respektim i dallimeve ndërmjet njerëzve;Tolerancë dhe respekt për të tjerët; Përgjegjësi për çështje dhe interesa të përgjithshme publike dhe pjesëmarrje e përgjegjshme qytetare; Përkrahje dhe nisje e ndryshimeve të dobishme për jetënpersonale, për tërë shoqërinë dhe për mjedisin.

Reduktimi i përmbajtjeve mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndëve (RNL) dhe (RNF)

Në vitin shkollor 2020/21, shkurtimet e domosdoshme duhet të bëhen patjetër, por ato nuk duhet të bëhen në mënyrë të njëanshme duke favorizuar një fushë kurrikulare në raport me tjetrën, apo lëndë të caktuara, e as në kurriz të lëndëve zgjedhore ndaj atyre të obligueshme.

Edhe në 2 skenarët e parë, grupi i kurrikulës në MASH do të përcaktojë një version më të përmbledhur të RNF dhe RNL për mësimin në kushtet e pandemisë, përfshirë edhe mësimin në distancë.(Orari tashmë i përpunuar për planin mësimor sipas mësimit në distancë, mund të aplikohet edhe në skenaret 1 dhe 2).

Grupet e mësimdhënësve trajnerë, së bashku me trajnerët e kurrikulës janë angazhuar tashmë në aktivitetet planifikuese ku:

- **përcaktohet minimumi i domosdoshëm i RNL-ve që duhet të arrihet sipas niveleve dhe shkallëve kurrikulare në cdo lëndë mësimore**
- **përfshihen në mësim, tema dhe informacione për pandeminë (sipas moshës së nxënësve) dhe masat adekuate për parandalim[22] dhe[23] raportim.**
- **Edukimi medial dhe siguria në internet, të kenë prioritet, në kushtet e zbatimit të mësimit në distancë**
- **Nxënësve t'u ofrohen platforma që janë lehtë të qasshme dhe të përdorshme për mësim**
- **Të ndërrmerren masa për të parandaluar stigmatizimin dhe diskriminimin për nxënësit dhe personelin e infektuar nga COVID-19 ose të jetesës në një familje të infektuar me COVID-19**

MASH është duke përgaditur protokolin e detajuar të temave e njësive mësimore të e-mësimit (TV-njësitë)[24] për cdo klasë dhe lëndë, prandaj në bazë të atyre njësive, do të munden edhe mësimdhënësit të planifikojnë pjesën tjetër të e-mësimit, detyrat, kuizet, shpjegimet shtese, kontaktin etj.(të vendoset vegza e udhezuesit /protokollit për mësimin në distancë).

Rekomandimet për organizimin Metodik-didaktik të Proceseve të Mësimdhënies dhe Mësimnxënies

Për organizim metodik-didaktik të proceseve të mësimdhënies edhe në kushtet e pandemisë COVID-19, duhet të vazhdojnë të zbatohen 5 parimet themelore të Kurrikulës së arsimit parauniversitar në Kosovë:

- **Gjithëpërfshirja**
- **Zhvillimi i kompetencave**
- **Mësimdhënia dhe të nxënit e integruar dhe koherent/të ndërlidhur**
- **Autonomi dhe fleksibilitet në nivel shkolle**
- **Përgjegjësia dhe llogaridhënia**

Më tepër informacione dhe shpjegime se si të zbatohen këto parime gjeni në dokumentin bazë të Kornizës Kurrikulare fq (25-28)[25].
Në kushtet emergjente të organizimit të mësimit në kohë pandemie, mund të merren ne konsideratë edhe disa parime shtesë, përvoja nga vendet e tjera (dokumentet e UNICEF

[22] https://unicef.sharepoint.com/teams/ECARO-Education/SitePages/Considerations-for-quality-and-inclusive-education.aspxConsiderations for education decision-makers at national, local and school levels, UNICEF Europe and Central Asia – Area 4 Safe schools
[23] https://reliefweb.int/sites/reliefweb.int/files/resources/safe_back_to_school_guide_16.5.20.pdf
[24] Linku I protokolinoseudhezuesin per e-mesimin
[25] https://masht.rks-gov.net/korniza-e-kurrikules-e-arsimit-parauniversitar

dhe GIZ) si dhe standardet minimale të propozuara për aspektin e mësimdhënies dhe të mësimnxënies nga INEE (International Network for Education in Emergencies).[26]

Standardi -1 -Kurrikula:
Përmbajtjet janë relevante me kontekstin, gjuhët, nevojat dhe aspektin social të nxënësve.

Standardi 2-Zhvillimi profesional i mësimdhënësve/Trajnimet
Mësimdhënësit dhe personeli tjetër trajnohen sipas nevojës dhe rrethanave të krijuara.

Standardi 3- Metodologjia e mësimdhënies
është me nxënësin në qendër, gjithëpërfshirëse dhe me pjesëmarrje aktive.

Standardi 4- Çmuarja dhe vlerësimi:
Metodat për vlerësim janë të përshtatshme dhe të bazuara në rezultatet e të nxënit.

Parime shtesë relevante për mësimin në kushtet emergjente

- Duhet siguruar që nxënësve t'u ofrohet një informacion kthyes cilësor për proceset e tyre të të mësuarit dhe kryerjen e detyrave. Kjo mund të bëhet në mënyra të ndryshme, për shembull përmes informacionit kthyes me shkrim të mësimdhënësit, reagimet nga kolegët, kontrolli i të vetë-mësuarit, diskutimet gjatë fazave të prezencës (nëse ndodhin) ose përmes reagimeve të automatizuara për formatet e të mësuarit digjital. Informacioni i kthyer **duhet të jenë formativ.**
- Për mësimin në shtëpi, nxënësve duhet t'u jepen **detyra stimuluese kognitive,** sociale dhe afektive (detyra "të mira"), të cilat mund të kryhen në nivele të ndryshme, e pjesërisht edhe në bashkëpunim. Për këtë qëllim duhet të përkrahen edhe bashkëpunimet e nxënësve në forma telefonike ose digjitale.
- **Aftësia vetë-rregulluese** e nxënësve duhet të forcohet përmes mbështetjes adekuate. Kjo mund të bëhet, p.sh. në mënyrë interaktive ose përmes pyetësorëve të vetë-kontrollit. Materialet e dhëna për mësim dhe detyrat duhet të hartohen në atë mënyrë që nxënësit të mund t'i kryejnë detyrat në mënyrë të pavarur ose në grupe me koleget dhe kolegët e klasës.
- Hartimi metodik-didaktik i proceseve të mësimdhënies dhe mësimnxënies nuk duhet të reduktohet në **një ofrim më pak produktiv të përmbajtjes mësimore,** për shembull duke ju dhënë numër të madh të obligimeve mësimore. Kjo vlen sidomos në skenarin e ndjeshëm të mësimit të kombinuar me prezencë në klasë për kohë të kufizuar dhe atij në distancë.
- **Kompetencat themelore, në veçanti leximi, shkrimi dhe matematika** si kualifikime kyçe duhet të promovohen vazhdimisht dhe në mësimin e të gjitha

[26] INEE https://inee.org/standards/domain-3-teaching-and-learning

lëndëve. Nga pikëpamja metodike-didaktike duhet konsideruar detyra inteligjente të përshtatshme për lëndët e veçanta.

- Adresimi i përmbajtjeve mësimore për zhvillimin e **kompetencave digjitale** siç janë shfrytëzimi i mediumeve digjitale për kërkimin dhe vlerësimin e informacionit, bashkëpunimi dhe prodhimi duke përdorur media digjitale. Vetëm kështu shtrohet fundamenti për përdorimin e mundësive mësimore në bazë digjitale nga nxënësit.
- Në aspektin metodik-didaktik duhet të promovohet të mësuarit sipas parimit të **modelit 4-K (komunikimi, kooperimi, kreativiteti, mendimi kritik)**, edhe në kuptimin e zgjeruar të kompetencave jo të automatizuara, dhe në këtë mënyrë të forcojnë spontanitetin, intuitën dhe të menduarit të tërthortë.

Për organizim metodik-didaktik të proceseve u referohemi skenarëve të përgatitur nga UNICEF, dhe konceptin sipas parimeve të propozuara nga GIZ dhe FES.

SKENARI A dhe B
Mirëpritja e nxënësve përsëri në shkollë[27]

Përderisa rihapen shkollat pas izolimit, mësimdhënësit duhet të mirëpresin të gjithë nxënësit për kthimin në shkollë pa e ditur vërtet se çfarë kanë përjetuar ata në shtëpi gjatë javëve ose muajve të fundit.

- **Forcohet partneriteti midis shtëpisë dhe shkollës;**
- **Ballafaqohemi me përvojat dhe ndjenjat e ndryshme rreth kthimit në shkollë;**
- **Pjesëmarrja, ndjenja e përkatësisë dhe rivendosja e marrëdhënieve duhet të sigurohen para se fëmijët të jenë të gatshëm të mësojnë përsëri në klasë/shkollë.**

SKENARI A, B dhe C - Krijimi i mënyrave të personalizuara/ individualizuara të të nxënit[28]

Ekziston frika nga një valë e dytë e pandemisë dhe disa kufizime të lirisë së lëvizjes dhe lirisë së tubimit ka të ngjarë të mbeten në fuqi për ca kohë. Shqetësimet zgjerohen në komunitetet ku jetojnë fëmijët, prandaj nevojitet koordinim dhe komunikim ndërmjet shkollave dhe përfaqësuesve të komunitetit. Institucionet arsimore gjithëpërfshirëse janë të suksesshme vetëm nëse ato përdorin një qasje të përqendruar te nxënësit, ku:

Për të lehtësuar tranzicionin dhe sfidat e kalimit nga mjedisi shtëpiak tek ai në shkollë nën rrethana të ndërlikuara duhet të:

[27] Për më shumë udhëzime shih manualin pedagogjik për mësimdhënës nga UNICEF LearnIn pjesa 2 – mirëpritja e nxënësve sërish në shkollë https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-2-mirepritja-e-nxenesve-serish-ne-shkolle.pdf
[28] Për më shumë udhëzime shih manualin pedagogjik të UNICEF LearIn pjesa 3 https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-3-krijimi-i-menyrave-te-personalizuara-te-te-nxenit.pdf

- **Të nxënit e nxënësve dhe përvoja e përgjithshme e tyre e të nxënit është në qendër të mësimdhënies, e jo mësimdhënësi;**
- **Përvetësimi i shkathtësive për zgjidhjen e problemeve shihet si më e rëndësishme se sa të dihet përmbajtja e kurrikulës;**
- **Bashkëpunimi ndërmjet nxënësve inkurajohet për t'u mundësuar atyre të mësojnë nga njëri-tjetri.**

Skenari C - Mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit - mësimi në distancë[29]

Në përgjithësi, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, iu kushtohet shumë vëmendje "njohurive të fushës" (elementet e përmbajtjes së një kurrikule, lëndët si p.sh. matematika, tema, njësia) dhe mjeteve (fletët e punës për të shkruar, letra dhe lapsa, tekste shkollore, format digjitale të të nxënit, kompjuteri etc). Fokusi kryesor duhet të jetë te të nxënit e nxënësit, jo vetëm tek njohuritë për fushë/lëndë apo mjetet që përdoren. "E drejta për arsim" kuptohet si "E drejta për të nxënë" - madje edhe në mungesë të arsimit formal.Prandaj, secili **mësimdhënës/edukator/prind** (me nxënësin në një rol aktiv dhe bashkëveprues) duhet të:

- **Njohë mirë situatën e nxënësve;**
- **Identifikojë qëllimet kuptimplota për të mësuar në shtëpi;**
- **Përzgjedh fushat relevante të njohurive e kompetencave;**
- **Përfitojë nga mjedisi mësimor në shtëpi –duke pasur nxënësin në qendër me theks në të nxënit e tij/saj;**
- **Përdor mjete dhe strategji për të mbështetur nxënësit nga distanca.**

Mësimi Plotësues

Në përgjithësi, gjatë procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies, iu kushtohet shumë vëmendje "njohurive të fushës" (elementet e përmbajtjes së një kurrikule, lëndët si p.sh. matematika, tema, njësia) dhe mjeteve (fletët e punës për të shkruar, letra dhe lapsa, tekste shkollore, format digjitale të të nxënit, kompjuteri etc). Fokusi kryesor duhet të jetë te të nxënit e nxënësit, jo vMësimi Plotësues bazohet në nevojat e nxënësve dhe komuniteteve. Mësimi plotësues duhet të planifikojë përfshirjen e nxënësve të cilët nuk kanë ndjekur mësimin gjatë periudhës Mars – Qershor 2020, apo edhe ata që do te kenë vështirësi që të ndjekin mësimin online edhe prej shtatorit e me tej. Sipas raportit të MASH, 9070 nxënës nuk kanë ndjekur mësimin gjatë kësaj periudhe për arsye të ndryshme, por arsyeja kryesore ka qenë gjendja e vështirë socio-ekonomike dhe mungesa e pajisjeve teknologjike.

Duke pasur parasysh se udhëzuesi për vlerësim nuk ka paraparë që nxënësit të përsërisin klasën, atëherë parashihet qënxënësit të regjistrohen në vitin vijues me gjithë faktin që nuk kanë ndjekur mësimin. MASH ka një raport nga komunat dhe ky regjistër duhet të jetë në

[29] Për më shumë udhëzime shih manualin pedagogjik për mësimdhënës nga UNICEF Learn In pjesa 1 – mbështetja e nxënësve gjatë izolimit në shtëpi
https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/07/manual-1-mbeshtetja-e-nxenesve-gjate-izolimit-ne-shtepi.pdf

dispozicion dhe të analizohet nëse të gjithë nxënësit kanë kaluar klasën apo ka ndonjë që ka përsëritur klasën.

Mësimi plotësues nuk mund të realizohet **gjatë një ose dy javëve** për të mbuluar tëgjitha mungesat që kanë fëmijët. Edhe nëse programi është i dizajnuar, do të duhej të ketë gatishmëri dhe përgatitje që të realizohet gjatë verës dhe kushte për të mbledhur fëmijët ose për t'u dorëzuar pajisjet. Kjo për shkak se arsyeja kryesore që nxënësit nuk kanë mundur të ndjekin mësimin ka qenë mungesa e pajisjeve.

Prandaj propozohet që mësimi plotësues të organizohet në mënyrë të vazhdueshme dhe të jetë në përputhje me kërkesat kurrikulare si dhe fëmijët në rrezik të identifikohen dhe t'u jepet prioritet për sigurimin e pajisjeve, internetit dhe përkrahjes para fillimit të vitit të ri shkollor. Përshembull GIZ planifikon të organizojë mësimin plotësues me shkollat kampion përmes qendrave mësimore sipas UA AI 19/18, të cilat do të organizojnë mësim plotësues për nxënësit që nuk e kanë ndjekur mësimin nga marsi e këtej si dhe mësimin paralel plotësues me mësimin e rregullt pasi të fillojë viti shkollor. Këto Qendra mësimore mund të iu ofrojnë ndihmë edhe nxënësve që kanë vështirësi në të nxënë dhe mbështetje më të madhe gjatë procesit të nxënies gjatë vitit shkollor.

Ky model mund të shikohet edhe për shkollat e tjera të Kosovës dhe të gjenden mjetet financiare për të përfshirë sa më shumë fëmijë. Secila shkollë duhet të modifikojë planin për mësimin plotësues, varësisht prej nevojave të nxënësve të vet. Për këtë arsye një program për mësim plotësues sipas klasave mund të dizajnohet dhe ofrohet por kjo kërkon implikime të mëdha financiare për të mbuluar të gjithë nxënësit. Eventualisht mund të shqyrtohet mundësia që Qendrat Mësimore ekzistuese në kuadër të disa shkollave të përfshijnë në mësimin plotësues edhe nxënës nga shkolla të tjera në afërsi gjeografike. Edhe gjatë ofrimit të mësimit plotësues duhet të respektohen të gjitha masat e shëndetit dhe sigurisë dhe numri maksimal i nxënësve i lejuar fizikisht në klasë.

Mësimi Plotësues

Vlerësimi i nxënies duhet të jetë në përputhje me mësimdhënien e realizuar dhe e bazuar në matjen e arritshmërisë së rezultateve të parapara të të nxënit sipas kurrikulës (RNF) dhe (RNL) si dhe në nivele e shkallë (RNSH).

Veprimet themelore sa i perket vleresimit te mesimit ne kushtet e pandemise, janë në përputhje me të gjitha veprimet e zakonshme për vlerësimin e arritjeve të nxënësve në kushte normale, por me kujdes të shtuar në situatën në të cilën janë nxënësit dhe me një vëllim të reduktuar.

Mësimdhënësit duhet të kenë parasysh se vazhdojnë të jenë të rëndësishme parimet:

- **Vlerësimi i vazhdueshëm i progresit të të nxënit e përcakton edhe metodologjinë e mësimit;**
- **Arritja e nxënësit dokumentohet dhe dëshmohet**
- **Metodat e vlerësimit duhet të jenë të drejta, të qëndrueshme dhe jo-ndëshkuese për nxënësit;**

- **Arritja e nxënësve duhet të njihet (zyrtarizohet) dhe të evidentohet edhe për qëllim të punësimit apo vazhdimit të arsimimit të tyre;**
- **Metodat e vlerësimit janë në përputhje me kodin etik;**
- **Vlerësimi është relevant dhe në përputhje me materialin, përmbajtjen, e i orientuar kahpërkrahja e nxënies.**

Funksionet e vlerësimit

Përcaktimi dhe vlerësimi përmbledhës (sumativ) i performancës, i cili bëhet në fund të procesit mësimorpërmbush funksione të ndryshme, të cilat janë të një rëndësie qendrore për procesin e ardhshëm të të mësuarit dhe karrierën arsimore të tashme dhe të ardhme të nxënësit. Me këtë rast duhet të bëhet dallimi në mes të:

a **Funksioni i informacionit kthyes:** Rezultatet e testit dhe notat përbëjnë informacion kthyes për nivelin e performancës. Ato janë instrument i rëndësishëm për t'u ndihmuar nxënësve të kenë një vetëvlerësim real të të mësuarit. Njëkohësisht janë të rëndësishme për motivim dhe kënaqësi gjatë të mësuarit.

b **Funksioni i certifikimit:** Provimet dhe diplomat (përfundimet) certifikojnë procese të suksesshme të të mësuarit dhe mundësojnë qasje në shtigje të mëtejme të kualifikimit, siç janë shkollimi profesional ose studimi. Kjo vlen edhe për dëftesat në përfundimet e cikleve të definuar të sistemit shkollor, dhe gjithmonë kur vendimet e obligueshme për kalimet në shkollat e caktuara varen nga notat e caktuara.

c **Mundësimin e krahasimit:** Vlerësimet e performancës mundësojnë, në njërën anë krahasimin social brenda grupit mësimor dhe në anën tjetër mundësojnë (së paku në mënyrë nominale) krahasime përgjatë një periudhe kohore, pra krahasimin në mes të gjeneratave të ndryshme.

Reduktimi i sasisë por jo në dëm të cilësisë së përmbajtjes dhe rezultateve të të nxënit

Në analogji të njëjtë me mësimin, edhe në kuadër të provimeve duhet të bëhet reduktimi i përmbajtjeve mësimore që do testohen gjatë provimit. Ajo që do të testohet në vitin e ardhshëm shkollor nuk mund të jetë e njëjtë si vitet e kaluara. Ky proces duhet të organizohet në mënyrë pragmatike.

Vlerësimi i përparimit të mësimit të nxënësve duhet të jetë në përputhje me udhëzimet dhe katër parimet e tij udhëzuese që janë nxjerrë nga MASH[30]. Ato përbëhen prej:

- **Vlerësimi formues paraqet bazën për vlerësimin përfundimtar;**
- **Sjellja etike;**
- **Mbështetja në normat ligjore;**
- **Kujdesi për kategoritë e cenueshme.**

[30] udhezuesin e MASH,i cili duhet te rishikohet
https://masht.rks-gov.net/uploads/2020/04/udhezues-per-vleresimin-e-nxenesve-gjate-mesimit-ne-distance.pdf

Në pajtim me këtë, spektri i përmbajtjes së provimit të të gjitha lëndëve duhet tëzvogëlohet dhe të pasqyrohet menjëherë në praktikën mësimore. Kjo nuk është sinonim i uljes së nivelit të cilësisë, sepse testet kërkuese mund të bëhen gjithashtu brenda një game të kufizuar në mënyrë sasiore të substancave;

- **Më pak përqëndrim në "fakte të vështira", por më tepër në procesin e të mësuarit dhe rezultatet e të nxënit;**
- **Detyrat e dhëna nuk kërkohet të jenë të njëjta për të gjithë - të kihen parasysh fëmijët me nevoja të veçanta dhe fëmijët e talentuar;**
- **Numri dhe fushëveprimi i provimeve siç janë detyrat në klasë apo testet gjithashtu duhet të zvogëlohen. Në vend të kësaj, vlerësimi i performancës duhet të ketë më shumë një funksion të informacioneve kthyese, në mënyrë që nxënësve t'u jepet mundësia që të rregullojnë procesin e tyre të të mësuarit në përputhje me rrethanat;**
- **Opsionet e testimit alternativ dhe mjetet në internet duhet të aplikohen për zhvillimin dhe administrimin e testeve në kohë reale, provimeve, detyrave në grup dhe detyrave të projektit, të cilat kryesisht janë të aplikueshme për nxënësit nga klasa 3 dhe më e lartë;**
- **Informacionet kthyese të menjëhershme mbi mësimnxënien duhet t'u jepen nxënësve në mënyrë që ata të informohen për të dhe të përmirësojnë të mësuarit e tyre, gjithashtu përmes platformave të ndryshme;**
- **Do të aplikohen opsione alternative të vlerësimit nëse është e mundur (parametrat e ndryshëm të provimit) dhe format e tjera të vlerësimit (në vend të notave);**
- **Vazhdimi i monitorimit të mësimeve dhe proceset shkollore.**

5. DIGJITALIZIMI I MËSIMIT NË SHKOLLA-PLATFORMAT, PËRGATITJA DHE ZBATIMI I MËSIMIT ONLINE

E - mësimi nuk e zëvendëson mësimin fizik për arsimin parauniversitar. E - Mësimi (skenari 3) mund të mbahet si alternativë e vetme vetëm nëse niveli i rrezikut është shumë I lartë dhe shkollat janë mbyllur tërësisht dhe gjendja e emergjencës publike është shpallur me udhëzim total të mbylljes. Megjithatë, strategjia e digjtalizimit dhe investimet në kohë krize, mund dhe duhet të jenë aktivitete të qëndrueshme, dhe të adresojnë çështjet urgjente, çështjet që zhvillohen në faza të njëpasnjëshme apo këto në kombinim. Në tabelën më poshtë, janë vendosur disa elemente kryesore që duhet të kemi parasysh kur zhvillojmë politika për aplikimin e teknologjisë në edukim.

Për tu realizuar mësimi online ekzistojnë disa parakushte:

- **Gjithpërfshirja;**
- **lidhja me internet;**
- **posedimi i pajisjeve (nga ana e nxënësve, shkollës dhe mësimdhënësve);**
- **transformimi i përmbajtjes online dhe përdorimi i platformave;**
- **trajnimi i mësimdhënësve dhe shkollave për përdorimin e platformave dhe mësimdhënien online.**

Gjithpërfshirja

Sipas raportit të MASH[31] ,9070 nxënës nuk kane ndjekur mësimin nga distanca. Sipas vlerësimit të GIZ për shkollat kampion, 11.5% të nxënësve nuk e kanë ndjekur mësimin nga distanca. Sipas raportit të FES,[32] 30 % e fëmijëve të familjeve më asistencë sociale të përfshirë në mostrën e studimit nuk kanë marrë pjesë në mësimin online.MASH poashtu ka raportuar mësimdhënie të pabarabartë të mesimdhënësve në mësimin nga distanca.

Arsyet kryesore të mospjesëmarrjes kanë qenë: mungesa e internetit, mungesa e pajisjeve nga ana e nxënësve, mungesa e pajisjeve nga mësimdhënësit dhe aftësitë e e tyre të kufizuara për përdorim, vështirësia e angazhimit për moshat e vogla dhe fëmijët me aftësi të kufizuar.

Objektivat urgjente dhe afatmesme e afatgjate të MASH:

- **Te zvogëlohet hendeku dhe pabarazia te grupet e margjinalzuara (urgjent)**
- **Të zvogëlohet pabarazia e bazuar në lokacionin I shkollës urban/rural, infrastrukturën dhe niveli i digjitalizimit dhe menaxhimit të shkollës (urgjent)**
- **Të rriten shkathtësitë e mësimdhënësve për të përdorur teknolgjinë në mësimdhënie (urgjent);**
- **Të kordinohet me donatorë të ndryshëm për të kontribuar me përkrahjen në mësimin online, edhe në shkollat që nuk kanë mbështetje momentale nga donatorë (urgjent).**

[31] Raport për organziminin e mësimin në distancë gjate pandemise 2020
[32] TABELA permbledhese-Mesimi_ nuk_mbajtur-mes.-distanca-SMIA-2019-2020

Lidhja me Internet

Penetrimi i internetit është vazhdimisht në rritje dhe mbi 90% për të gjitha grupmoshat dhe pa dallim nga vendet urbane dhe rurale (Kantar, 2019).

Objektivat:

- **Të identifikohen fshatrat ku nuk ka mbulueshmëri me internet dhe të bëhet Harta e Lidhjes me Internet, (urgjent dhe afatmesme)**
- **Të gjithë operatorët duhet të kontaktohen për të mbuluar zonat e pambuluara dhe qasjen për familjet të cilat nuk kanë kushte për abonim. (urgjent)**
- **Të bëhen plane operacionale me Vala, IPKO, Projekti Kode**

Posedimi i pajisjeve

Sipas Kantar (2019), 97% e popullatës kanë qasje në telefoni mobile, 37% kanë Smart TV, 30% kanë tablet, 39% kanë kompjuter dhe 48% kanë llaptop. Kosovarët qasen në internet më së shumti përmes telefonave mobil (74%), kurse arsyet kryesore të qasjes janë: komunikimi (93%), dëgjimi i muzikës (37%), leximi (35%), dëgjimi i lajmeve (22%), studimi dhe kërkimi (18%). Platformat më të përdorura janë viber (85%), facebook (67%), dhe instagram (51%).

Për mësimin nga distanca llogaritet që një pajisje mund të ndahet më së shumti mes dy fëmijëvë, për të arritur orarin minimal të ndjekjes, të angazhimit dhe dërgimit të detyrave.

Objektivat:

- **Të furnizohen shkolla me pajisje për nxënës dhe mësimdhënës (urgjent, afatmesem dhe afatgjate).**
- **Të evidentohen nevojat e nxënësve për pajsije duke zhvendosur një një pjesë të paraparë për blerjen e librave shtesë për të blerë pajisje.**
- **Të krijohet një klasë për teknologjinë e mësimdhënëis në shkollë dhe të emërohet një koordinator për digjtializim.**
- **Mësimdhënësit e një lënde mund të bëjnë rotacion të përdorimit të pajosjeve në klasë apo shtëpi dhe të kriojnë apo vendosin materialet sipas kurikulës.**

Transformimi i përmbajtjes online dhe përdorimi i platformave

Sipas Raportit të MASH, përveç e-mësimit në TV dhe kanalin YouTube, disa shkolla dhe mësimdhënës kanë përdorur platformat google classroom, microsoft teams dhe moodle, mirëpo shumica e mësimdhënësve kanë përdorur aplikacionet siç janë viber, zoom dhe

facebook. Kjo ka shkaktuar jo konsistencë në orar, drejtim, praktikë dhe angazhim si dhe ka pasur mungesë të theksuar të menaxhimit të nxënësve, nevojave të tyre, kontaktit të rregullt si dhe dhënien e informacioneve kthyese.

Objektivat:

- **E - mësimi TV të përdoret në kombinim mënjë platformë tjetër që menaxhohet nga shkolla;**
- **Shkolla të jetë përgjegjëse për menaxhimin e mësimit dhe nxënësve;**
- **Të jetë një adresë ku nxënësit dhe prindërit qasen, psh. E – mësimi;**
- **Shkollat të përkrahura nga komunat të vendosin për njërën nga platformat më poshtë;**
- **Mësimdhënësit të realizojnë detyrat e tyre në përkrahje të nxënësve sipas skenarëve në kombinim me prezencë në shkollë dhe me platforma.**

Në vijim paraqitet vlerësimi i platformave:

Tabela 4 Vlerësimi i platformave sipas aktiviteteve, gatishmërisë dhe kostos

Platformat	Aktivitetet e nevojshme	Vlerësimi i gatishmërisë 1-5(5 më e lartë) dhe karakteristikat	Kosto/Kushtet
E- Mësimi TV https://emesimi.rks-gov.net/shq/	- Aplikohet në të gjitha skenaret për klasat 1-9 - Të përdoren tabela virtuale për lëndët si matematika - Te plotësohet Udhëzuesi metodologjik	5 - qasje gjithëpërfshirëse per klasat 1-9 - TV - Online në të gjitha pajisjet - 10-15 min për lëndë në ditë	Udhëzuesi i Bashkëngjitur
Google Suite For Education https://edu.google.com/products/gsuite-for-education/?modal_active=none	- Të paguhet internet për shkolla - Të bëhen uebfaqet për shkolla - Të aplikohet për google suite - Të regjistrohen nxënësit dhe mësimdhënësit - Të bëhen trajnimet për mësimdhënësin	4 - Sinergji me google apps docs, drive, etj - Ndarja modifikimi interaktiv i dokumenteve - Kompatibil me pajisjet - Punon edhe me internet te dobët - Mund të realizohen video me deri në 100 veta. - Me cilësi të lartë dhe kontroll nga menaxhuesi - I përshtatshëm edhe për aktivitete jashtë shkollore dhe live stream - Lidhja me kalendar - Mundësi incizimi i videove	Udhëzuesi i Bashkëngjitur
Microsoft Office 365 for Education që përmban MS Teams https://www.mtechsystems.co.uk/microsoft-teams-for-education/	- Të paguhet internet për shkolla - Ekziston domaini www.shkollat.org - Aplikacioni/softueri mund të ofrohet nga MASH/ASHI pa pagesë - Të regjistrohen nxënësit dhe mësimdhënësit - Ekziston edhe udhëzuesi i	5 - Interaksion me video, voice, mesazhe - Përdorim i Programeve Micrososft - Lidhet me mjete tjera të mësimit - Forma për detyra, kuize. - Upload te materialeve në Class Notebook - Diskutime, projekte.	0 (kusht uebfaqja, aplikimi, aprovimi) Udhëzues të gatshëm të bërë nga disa universitete që mund të modifikohen

	përgatitur për versionin arsimor në gjuhën shqipe - Të bëhen trajnimet për mësimdhënësin		
Platforma E-shkollori, https://eshkollori.com/index	- Të paguhet internet për shkolla/ - Të regjistrohen nxënësit dhe mësimdhënësit - Të bëhen trajnimet	3 - Ka anën e administrimit dhe vlerësimit - Mundëson ngarkimin dhe shkarkimin për vendosje dhe dërgim të detyrave - I mungojnë aplikacionet interaktive - Mund të kombinohet me google (shih udhëzimet më lartë)	?
Moodle https://moodle.org/	- Të paguhet internet për shkolla/ - Të bëhen uebfaqet për shkolla - Të regjistrohen nxënësit dhe mësimdhënësit - Të bëhen trajnimet	3 - Regjistrim i lehtë - Qasje në të gjitha pajisjet - Miqësore - Ofron të gjitha llojet e dokumenteve, dhe burimeve dhe detyrave - Mundësi modifikimi - Jep te dhëna - Mundësi për notim	0 Kërkohet uebfaqe, dhe administrator në shkollë
Learn INuhttps://learnin.wiki/en/FAQ/tools Various tool and platforms	- Të paguhet internet për shkolla/ - Të bëhet vlerësimi	3 Kombinim i mjeteve https://drive.google.com/file/d/1DBfxJEvdvLUPBërB_kmY2izufiJ3Psdn/vieë	0 Të merren info më shumë nga UNICEF
Tjera të krijuara për qëllime apo grup te caktuar http://arsimigjitheperfshires.rks-gov.net	- Qasja ne uebfaqe te MASH - Të përmirësohet vazhdimisht	4	0

Elementet kyqe për përzgjedhjen e zgjidhjeve teknologjike në edukim

Përzgjedhja e zgjidhjeve teknologjike në edukim bazohet në kriteret për zhvilimin sipas fazave, ndërlidhjen me politikat, përgjegjësitë e autoritetit zbatues, përfshirja e institucioneve dhe kompanive profesionale dhe kushteve të financimit. Sugjerohet qasja e qëndrueshmërisë që do të thotë investimi i menduar mirë dhe që mund të përkrah digjitalizimin e mëtujeshëm në të ardhmen.

Tabela 5 Paraqitja e elementeve e kritereve për përzgjedhjen e teknologjisë

Elementet	Fazat	Nderlidhja me politikat	Autoriteti Zbatues	Perfshirja e institucioneve/ kompanive profesioniste	Financimi
1) Vizioni dhe planifikimi:	Faza Urgjente Kombinim	COVID 19 Digjitalizimi i Shkollave	MASH Ministria e Inovacionit, Teknologjise, ASHI, Komunat	Kompani profesioniste, NGO, Donatore si këshilltare	Urgjent Afatmesëm Afatgjatë
2) Barazia, përfshirja dhe siguria	Niveli i Rrezikshm ërise	COVID 19 Masat e Sigurisë dhe Shëndetit Pajisjet Transporti Programi Plotesues Perkrahja Psiko Sociale	MASH MSH IKSHP DKA Institucionet		Urgjent
3) Infrastrukt ura	Urgjente Faza Kombinim	Interneti Incizimet TV Platforma Digjitalizimi i Shkollave	MASH Zhvillimi Ekonomik Inovacioni Komunat Donatorët	TBC	Urgjent Afatmesëm
4) Mësimdhë nësit		Zhvillimi Profesional Licencimi Kompetencat Digjitale	MASH Komuna	Donatore	Urgjent Afatmesëm
5) Qasja Metodolog jike	Urgjente Faza Kombinim	Kurrikula Bazë (minimum I detyrueshëm) Kurrikulumi i integruar Vetë drejtimi rritet me moshë Përmbajtja sipas klasave e ndarë ne: **E mësimi TV,** (1 video në ditë per klasë) **E mësimi Platforme,** materiale për lexim,	MASH Komunat Shkolla	Donatore Organizata/	Urgjent

		kuize, video, detyra, feedback, kontakt virtual), Elementet sociale dhe ndërlidhjet kurrikulare **Edukimi shëndetësor,** **Edukimi qytetar,** **Edukimi artistik,** **Kompetencat Digjitale** **Mësimi Plotësues**	Organizata dhe kompani profesionale		
6) Materialet mësimore	Librat bazë Materialet online	Kurrikulimi i integruar Mësimi në TV -video Librat bazë Materialet online të	MASH Mësimdhënësit	Donatore Organizata /Kompani profesionale	
7) SMIA	SMIA SMI-SHkolla Ditaret Elektronik	Digjitalizimi i Shkollave Shkollat.org	MASH Komunat	Donatore Organizata /Kompani profesionale	
8) Monitorimi dhe Vlerësimi	Urgjent Sistematik	Digjitalzimi i shkollave COVID 19 Shëndeti dhe Siguria Modernizimi i Inspektoratit te Arsimit	MASH	Donatore Organizata /Kompani profesionale	

6. MONITORIMI DHE INSPEKTIMI

Inspektorati i Arsimit i kryen detyrat përmes inspektimit të përgjithshëm, tematik, emergjent, riinspektimit si dhe inspektimit të cilësisë dhe vlerësimit të performancës së mësimdhënësve.

Në përputhje me Planin për Rikthimin në Shkolla në Kohë të Pandemisë apo mësimin nga distanca, Inspektorati ka proritetet në vijim:

- **Shkollat dhe metodat e mësimit respektojnë protokollin për siguri dhe shëndet dhe mirëqenjen e fëmijëve;**
- **Nxënësit nuk mbeten prapa për shkak të statusit të tyre social, ekonomik apo rrethanava të veçanta;**
- **Mënyra e inspektimit i përshtatet kushteve në kohë pandemie dhe mësimit nga distanca.**

Afati kohor	Aktiviteti	Aktivitetet e Inspektoratit	Dokumentet e nevojshme	Intervenimet	Buxheti
Korrik/ Gusht	Kordinimi me TASK Forcën	Caktimi i anëtarit në TASK Forcë. Marrja në mbledhjet e TASK Forcës Përpilimi i pjesës së vlerësimit të jashtëm dhe inspektimit	E-Mësimi Platformat Skenaret Protokollet		
Gusht	Gatishmëria e institucioneve parashkollore/ shkollave për rifillim të mësimit **Skenari 1 ose 2** Orari dhe Protokolli i monitorimit të gatishmërisë së shkollave	Përgatitja e protokollit për inspektorë Orari i inspektimit të shkollave Dhënia e rekomandimeve nëse shkolla i ka plotësuar kushtet për rifillimin në skenarin 1 dhe 2	Protokolli Lista e kontrollit; Kushtet per hapjen e shkollave dhe punën sipas skenareve; Raporti dhe Rekomandimet	Trajnimi një- ditor i inspektoratit të MASH dhe inspektorateve sanitare të komunave për skenarët dhe masat COVID19 Inspektimi sipas protokolit Ekspert **6 ditë**	
Gusht	Gatishmëria e institucioneve parashkollore/ shkollave për mësimin me platforma Skenari 1 , 2, 3	Kontrollimi nëse shkollat në secilën komunë janë përcaktuar për një platformë sipas listës së kontrollit; Kontrolli i regjistrimit të nxënësve dhe angazhimit online; Caktimi i klasave për digjitalizim; Caktimi i koordinatorit	Udhëzimet për platformat; Caktimi i inspektorëve; Marrja e raporteve nga platformat; Analizimi i raporteve; Raportimi mujor	Zhvillim profesional i inspektoratit per funksionimin e platformave 6 ditë Ekspert i jashtëm për marrjen e raporteve, analizimin dhe raportimin 40 ditë	

Gusht 2020-Qershor 2021	Monitorimi i Trajnimeve të mësimdhënë sve	Të merret orari i trajnimeve; Të caktohen inspektorët për monitorim; Të përgatitet metodologjia; Të bëhet monitorimi; Të bëhet raporti.	Modulet e Trajnimeve; Orari i Trajnimeve; Trajnerët Materialet e trajnimit	Sipas orarit	
Shtator 2020-Qershor 2021	Inspektimi i rregullt	Caktimi i inspektoreve; Orari i inspektimit të shkollave; Raportet e inspektimit; Dhënia e rekomandimeve.	Udhëzuesit	Inspektorët	
Shtator 2020-Qershor 2021	Modernizimi i Inspektoratit përmes platformës online	Percaktimi për platformën online për indikatorët e performancës; Integrimi i të dhënave nga SMIA dhe SMIAL në Platformë COVID 19 raportime online	Indikatorët Raportet	Inspektorati i Arsimit Kompani e specializuar	TBC

7. TRAJNIMI I MËSIMDHËNËSVE, PERSONELIT MENAXHERIAL DHE PËRKRAHËS TË SHKOLLAVE DHE AKTERËVE TJERË

Trajnimet obliguese kualifikuese për mësimdhënës

MASH-DIVIZIONI I TRAJNIMEVE ka definuar listën me trajnimet bazë të domosdoshme për të zbatuar cilindo nga skenaret e mundshëm të propozuar në këtë dokument. Gjithashtu duhet të definojë në baza pedagogjike kërkesat minimale për përdorim të teknologjive digjitale. Në mënyrë që proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies të organizohen në mbështetje digjitale ekziston nevoja për një ofertë kualifikimi, në të cilin do të kenë qasje mësimdhënësit sipas kërkesave dhe nivelit të kompetencave të tyre.

Veprimet më urgjentë në lidhje me trajnimet obliguese për mësimin online janë:

- **Koordinimi i DKA lidhur me kërkesat dhe nevojat e trajnimeve për mësimdhënës;**
- **Trajnimi i mësimdhënësve pasi të përcaktohet MASH për platformë do të planifikojmë trajnimin e mësimdhënësve për udhëzime për përdorimin e platformës nga ofruesi i platformës ose organizatë profesionale;**
- **Trajnimi i mësimdhënësve për metodologji të mësimit online sidhe i punës eksperimentale;**
- **Ofrimi i trajnimit të mësimdhënësve për mjete të TIK-ut**
- **Ofrimi I këshillimit DKA-ve i mësimdhënësve dhe prindërve për përdorimin e mjeteve të TIK-ut;**
- **Trajnime për metodat e mësimdhënies online dhe të kombinuar.**

Përveç mësimdhënësve, të gjithë akterët ballafaqohen me mësimin online, prandaj programi i trajnimeve duhet të përfshijë edhe trajnime të tjera që rrisin produktivitetin, komunikimin dhe koordinimin në kohë pandemie.

Trajnimet e Propozuara

Në vijim janë disa nga trajnimet që propozohen për t'u ofruar.

Modulet	Kohëzgjatja dhe Grupet	Mënyra	Koha
Masat COVID-19 për Mësimdhënës, drejtorë dhe prindër https://resourcecentre.savethechildren.net/node/17551/pdf/learn_covid-19_tool_teachers_module_1_-_self-study_1.pdf	Të konfirmohet me Save the Children	Online	Java e parë e Shtatorit
1.Mbështetja e nxënësve në shtëpi gjatë izolimit- mësimi në distancë	Të konfirmohet me UNICEF	Online	Të caktohet
2.Mirëpritja e nxënësve përsëri në shkollë	Të konfirmohet me UNICEF	Online	Të caktohet
3.Krijimi i menyrave /formave të të nxënit të bazuara në nevojat individuale të nxënësit/ve	Të konfirmohet me UNICEF	Online	Të caktohet
Masat COVID 19 për shkolla- Ruajtja e shëndetit publik, drejtorët dhe inspektorët, DKA	2 orë	Online	Java e dytë e Gushtit
Mbajtja e higjienës dhe produktet higjienike për kompanitë e pastrimit, pastruesit dhe personelin teknik	1 orë	Online Video (5 min)	Java e dytë e Gushtit
Masat COVID 19 në Shkollë për nxënës, mësimdhënës dhe prindër. Shpjegimet per shkenarët, masat, mënyrën e raportimit	2 orë	Video	Java e parë e Shtatorit
Përdorimi I pajisjeve			
Marrja, huazimi dhe kthimi I pajisjeve	1 orë		Java e parë e Shtatorit
Kompetencat Digjitale dhe Përdorimi I Platformave			
Përdorimin e pajisjeve teknologjike në klasë (Moduli BE) Klasat 1-5	3 ditë		24 gusht deri më 4 Shtator 2020
Përdorimin e pajisjeve teknologjike në klasë (Moduli BE) Klasat 6-9, 10-12	3 ditë		24 gusht deri më 4 Shtator 2020
Përdoruesit: regjistrimi, mbrojtja e të dhënave dhe siguria online	1 ditë		Të caktohet

Përdorimi I Platformës Google Suite	1 ditë	Online + Tutorial me video	Të caktohet
Përdorimi I Platformës MICROSOFT	1 ditë	Online + Tutorial me video	Të caktohet
Përdorimi i Platformës E-shkollori	1 ditë	Online + Tutorial me video	
Përdorimi I Platformës E- mësimi	1 ditë	Online + Tutorial me video	
Përdorimi I Platformës Edukimi I hershëm	1 ditë	Online + Tutorial me video	Të caktohet
Përdorimi I Platformës Edukimi I hershëm	1 ditë	Online + Tutorial me video	Të caktohet
Edukimi gjithpërfshirës (Moduli i BE) Përdorimi i Platformës Arsimi gjithpërfshirës	1 ditë	Online + Tutorial me video	Të caktohet
Mësimdhënia Online			
Aftësimi i mësimdhënësve, auditorëve dhe redaktorëve per E-Mësimi (Nga Projekti E Mësimi)	40 ditë	Fizik	Vazhdueshëm
Planifikimi sipas Kurrikules (Moduli i BE) + Transformimi I materialeve online	3 ditë	Online	Vazhdueshëm
Vlerësimi online, Moduli nga BE	3 ditë	Online	Vazhdueshëm
Të menduarit kritik dhe kreativ	3 ditë		
Mësimi Plotësues	3 ditë		Vazhdueshëm
Menaxhimi			
Takimet online Microsoft Teams	2 orë	Online	
Raportimi	5 ditë	Online	Të caktohet
Inspektimi i mësimdhënies përmes platformave, analiza e përfshirjes, rezultatet, Përkrahja Inspektoratit	40 ditë		Vazhdueshëm

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

UDHËZUES

I PËRGJITHSHËM I MASH

PËR ORGANIZIMIN E MËSIMIT
NË VITIN SHKOLLOR 2020/2021
NË KUSHTET E PANDEMISË
COVID 19

FRIEDRICH EBERT STIFTUNG Büro Kosovo

KOSOVA që duam

german cooperation DEUTSCHE ZUSAMMENARBEIT

Implemented by: giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Mbështetur nga zyra e **UNICEF** në Kosovë